



**Mbështetje Institucionale për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe
Administrimit të Ujërave për Ruajtjen dhe Përdorimin e
Qëndrueshëm të Biodiversitetit në Zonat e Mbrojtura**

**Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar
Shebenik-Jabllanicë**

2016-2025

Tetor 2015

Përmbajtja

FALËNDERIME	4
SHKURTIMET.....	6
HYRJE	7
PJESA 1: PËRSHKRIMI I ZONËS.....	12
1.1 Vendndodhja dhe Konteksti	12
1.2 Kuatrit Rregullator dhe Institucional	14
1.2.1 Statusi Ligjor	14
1.2.2 Politikat dhe Legjislacioni.....	15
1.2.3 Grupet e Interesit	16
1.2.4 Kuatrit i Qeverisjes dhe Menaxhimit	17
1.3 Sistemi ekologjik dhe socio-ekonomik i Parkut	19
1.3.1 Vështrim i përgjithshëm.....	19
1.3.2 Struktura e Ekosistemit, Shërbimet e Ekosistemit dhe Veprimtaritë Ekonomike.....	23
PJESA 2: VLERËSIMI I ZONËS SË MBROJTUR	29
2.1 Vlerësimi i Vlerave	29
2.2 Vlerësimi i Kërcënimeve	32
2.3 Vlerësimi i Kuadrit Institucional.....	33
PJESA 3: MENAXHIMI I ZONËS SË MBROJTUR	35
3.1 Pozicionimi i këtij Plani në hierarkinë e vendimmarrjes	35
3.2 Vizioni dhe Objektivat	36
3.3 Zonat e Menaxhimit	36
3.4 Masat dhe Veprimet e Menaxhimit	38
3.4.1. Qëllimi i Menaxhimit 1: Ruajtja e Vlerave Ekologjike.....	39
3.4.2. Qëllimi i Menaxhimit 2: Zhvillimi Rural duke u Mbështetur në Përdorimin e Qëndrueshëm të Shërbimeve të Ekosistemit	52
3.5 Programi i Monitorimit	65
PJESA 4: PLANI I BUXHETIT	66
4.1 Programi i Monitorimit	66
4.2 Masat e Menaxhimit: Preventivat/përlllogaritjet e Buxhetit dhe Afateve Kohore	71
PJESA 5: VLERËSIMI I ZBATIMIT	74
PJESA 6: REFERENCAT / BIBLIOGRAFIA.....	81
PJESA 7: SHTOJCAT	89
Shtojca 1. Hartat.....	89
Shtojca 2. Vështrim i Përgjithshëm i SMV-së- Sistemit të Mbështetjes së Vendimeve.....	89
Shtojca 3. Shpallja e PKSHE-së	89
Shtojca 4. Nivelet e mbrojtjes së zonave të mbrojtura në Shqipëri	89
Shtojca 5. Lista e ligjeve dhe politikave kryesore mjedisore	89

Shtojca 6. Llojet e bimësisë së PKSHJ-së	89
Shtojca 7. Fauna e Regjistruar në PKSHJ	89
Shtojca 8. Përshkrimi i komponentëve të PKSHJ-së	89
Shtojca 9. Analiza e Sistemit Shkak-Pasojë dhe Identifikimi i Veprimeve të Menaxhimit.....	89
Shtojca 10. Hollësitë e Programit të Monitorimit	89

FALËNDERIME

Së pari, do të donim të falënderonim punonjësit e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të Rrethit Librazhd, Drejtorin dhe stafin e tij teknik për kontributin dhe asistencën e tyre të vazhdueshme gjatë përgatitjes së planit të menaxhimit si edhe për pjesëmarrjen entuziaste në seminarët dhe fushatat e shumta për mbledhjen e të dhënave në terren.

Do të donim të falënderonim gjithashtu edhe stafin e Drejtorisë së Biodiversitetit, Sektorit të Zonave të Mbrojtura pranë Ministrisë së Mjedisit në Tiranë, të cilët morën pjesë aktive në seminarët dhe trajnimet e ndryshme teknike.

Në veçanti do të donim të falënderonim z. Mirjan Topi, i OJQ-së PPNEA, i cili me pasion i kushtoi një pjesë të madhe të kohës së tij punës për hartimin e këtij plani menaxhimi, duke kontribuar në sigurimin e një komunikimi sa më të mirë mes stafit dhe ekspertëve të projektit dhe banorëve vendas, duke zgjidhur shumë probleme logjistike dhe duke dhënë kontribute të rëndësishme teknike.

Falënderojmë gjithashtu edhe z. Bledi Hoxha, po nga OJQ-ja PPNEA, i cili mundësoi përfundimin me sukses të veprimtarisë së filmimit me kamera (camera trapping) për realizimin e monitorimit të faunës së egër.

Do të donim të falënderonim të gjithë pjesëmarrësit në seminarët dhe veprimtaritë e trajnimit në vendin e punës të mbledhjes së të dhënave në terren, që dhanë një kontribut të vlefshëm për hartimin e Planit të Menaxhimit dhe që renditen në mënyrë individuale në kreun e Hyrjes.

Gjithashtu do të donim të falënderonim edhe kryetarin e bashkisë së Librazhdit dhe kryetarët dhe punonjësit e njësive bashkiake Stëblevë, Lunik, Qendër, Qarrishtë, Hotolisht, Qukës dhe Rrajcë, të cilët morën pjesë aktive në takimet e organizuara dhe u ofruan mbështetjen dhe kontributet e tyre ekipeve të ndryshme të ekspertëve.

Do të donim të falënderonim edhe Shoqatën e Grave të Librazhdit, nëpërmjet zonjës Liri Leka si edhe Zyrën Rajonale të Bujqësisë Elbasan dhe Inspektoratin e Peshkimit të Elbasanit për kontributin e tyre në ofrimin e të dhënave dhe mbështetjen për mbledhjen e të dhënave nëpërmjet përkatësisht z. Selami Gjika dhe z. Vasjar Shermadhi.

Do të donim të falënderonim të gjithë stafin e Laboratorit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, veçanërisht Dr. Xhume Kumanovën, ndihma e së cilës ishte thelbësore në vlerësimin e statusit të burimeve ujore në PKSHT.

Falënderojmë edhe Prof. Nevton Kodhelaj, i cili na siguroi informacione dhe të dhëna të vlefshme për hidro-gjeologjinë e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe znj. Marianthi Guri për ofrimin e të dhënave dytësore për faunën e egër dhe për asistencën në realizimin e ortofotove të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë.

Një falënderim i veçantë shkon për Dr. Alfredo Guillet-in, për kontributin e vazhdueshëm teknik që dha gjatë përgatitjes së Planit.

Së fundmi, do të donim të falënderonim të gjithë banorët vendas që jetojnë në Shebenik të cilët na ndihmuan në një mënyrë apo tjetër dhe të cilëve u kushtohet ky plan, me shpresën që do të kontribuojë në gjetjen e një ekuilibri mes veprimtarive dhe mjedisit të tyre, të vetëdijshëm që e ardhmja e qëndrueshme e njerëzimit do të kalojë në mënyrë të pashmangshme nëpërmjet kompromisit mes shfrytëzimit dhe respektit për burimet natyrore.

SHKURTIMET

BREN/RRERB	Rrjeti Ekologjik i Rajonit të Ballkanit
BUND/MTGJ	Miqtë e Tokës, Gjermani
CBD/KBD	Konventa për Diversitetin Biologjik
CBO/OBK	Organizatë Me Bazë në Komunitet
CEPF/FKPE	Fondi Kritik i Partneritetit për Ekosistemet
CITES/KTNLLRR	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara
DBPA/DBZM	Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura
DCM/VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
DFP/DPK	Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave
DGCS/DPBZH	Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim
SMV/SMV	Sistemi për Mbështetjen e Vendimeve
ECNC/QERN	Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës
EURONATUR/FEN	Fondi Evropian i Natyrës
EU/BE	Bashkimi Evropian
GIS/SIGJ	Sistemi i Informacionit Gjeografik
IBA/ZRSH	Zonë e Rëndësishme Shpendësh
IPA/ZRB	Zonë e Rëndësishme Bimore
IUCN/UNRN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
KBA/ZKB	Zonë Kryesore Biodiversiteti
MoE/MM	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
NACFP/SHKPKK	Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale
NAPA/AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
NEN/RREK	Rrjeti Ekologjik Kombëtar
NGO/OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
NTFP/PPJD	Produkt Pyjor Jo-Drusor
PA/ZM	Zonë e Mbrojtur
PEEN/RREPE	Rrjeti Ekologjik Pan-Evropian
PPNEA/MRMNSH	Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri
PROGES	Proges Consulting, Romë
RAPA/ARZM	Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura
RFSD/DRSHP	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor
SAC/ZVR	Zonë Veçanërisht e Ruajtur
SJNP/PKSHJ	Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë
SPA/ZVM	Zonë Veçanërisht e Mbrojtur
TFP/PPD	Produkt Pyjor Drusor
UNEP/PKBM	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
WWF/FMBN	Fondi Mbarë Botëror për Natyrën

HYRJE

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (PKSHJ ose Parku) përfshin disa nga zonat më të bukura malore në lindje të Shqipërisë. E ndodhur në Rrethin e Librazhdit në Qarkun e Elbasanit, zona u shpall park kombëtar në vitin 2008, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 33.928 ha (Shtojca 1, Harta 1). I shtrirë rreth burimeve të Lumit Shkumbin, Parku mbizotërohet nga male dhe lugina. Lartësia e tij mbi nivelin e detit varion nga 300 në 2.200 m dhe ai karakterizohet nga një shumëllojshmëri kushtesh klimatike, formacionesh gjeologjike, peizazhesh, habitatesh dhe llojesh bimore dhe shtazore. Nga pikëpamja njerëzore, PKSHJ-ja përfshin pjesë të gjashtë komunave, me sipërfaqe të përgjithshme prej 77.450 ha dhe popullsi 44.677 banorë.

Ky plan është plani i parë i menaxhimit që hartohet për PKSHJ-në. Ai është përgatitur në kuadrin e një projekti në vazhdim që i ofron mbështetje institucionale Ministrisë së Mjedisit të Shqipërisë, i financuar nga Bashkëpunimi Italian për Zhvillim (DGCS) dhe që zbatohet nga Zyra e Programeve të IUCN-së për Evropën Juglindore. Në kuadrin e këtij projekti, janë hartuar planet e menaxhimit për dy zona të mbrojtura, PKSHJ-në dhe Peizazhin e Mbrojtur të Lumit Buna. Në bazë të këtyre përvojave, po hartohet një udhëzues i përgjithshëm për përgatitjen e planeve të menaxhimit të zonave të tjera të mbrojtura në Shqipëri.

Ekipi i Planifikimit

Plani i menaxhimit të PKSHJ-së është përgatitur nga një ekip bazë i ekspertëve teknikë nga IUCN-ja, Proges Consulting dhe Universiteti Sapienza i Romës, në bashkëpunim me MM-në, Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Librazhd (DSHP) dhe organizatën vendase jo-qeveritare PPNEA (Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri). Ekspertë të tjerë teknikë nga PROGES kontribuan në procesin e planifikimit nëpërmjet studimeve këshilluese specifike dhe pjesëmarrjes në seminarët e planifikimit. Këto seminare përfshinë pjesëmarrjen e grupeve lokale të interesit në formën e përfaqësuesve të Komunave Hotolisht, Librazhd Qendër, Lunik, Qukës, Rrajcë dhe Stëblevë; DSHP Librazhd dhe Drejtorisë së Bujqësisë; Bashkisë Librazhd; Qarkut Elbasan dhe Agjencisë së Basenit Ujor të Lumit Shkumbin; si edhe ekspertë nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit, OJQ-të lokale dhe OBK-të.

Plani u përgatit dhe hartua nga konsulentët e mëposhtëm (sipas rendit alfabetik):

- Fabio Attore, Universiteti Sapienza i Romës
- Robert Cunliffe IUCN
- Michele De Sanctis IUCN
- Marco Falcetta PROGES Consulting
- Andrea Ghiurghi IUCN
- Tiziana Giuliani IUCN
- Francesca Pella IUCN
- Matteo Rossi IUCN
- Edoardo Scepi IUCN
- Mirjan Topi OJQ për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)

por u mbështet gjithashtu në kontributin e drejtpërdrejtë të shumë grupeve të interesit dhe bashkëpunëtorëve të projektit që morën pjesë aktive në 4 seminarët e organizuara në Librazhd për përgatitjen e këtij plani dhe mbledhjen e të dhënave gjatë fushatave në terren të viteve 2012 dhe 2013 në PKSHJ (sipas rendit alfabetik):

- Valbona Balla Specialiste në Zyrën Rajonale në Librazhd
- Maurizio Barbieri PROGES Consulting / Universiteti Sapienza i Romës
- Mitat Bicaku Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Librazhd
- Veri Bicaku Komuna Qendë, Librazhd
- Fatmir Brazhda OJQ "Dorez"

- Ariana Dashi OJQ "Shoqata e Grave", Librazhd
- Ahmet Duka Komuna Hotolisht, Librazhd
- Mauro Fasola PROGES Consulting / Universiteti i Pavis
- Ermelinda Gjeta Drejtoria e Shëndetit Publik, Librazhd
- Selami Gjoka Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Elbasan
- Belinda Hoxha Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit
- Bledi Hoxha OJQ "PPNEA"
- Spartak Hoxha Komuna Rrajcë, Librazhd
- Eriola Katiaj Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit
- Enver Koçi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Librazhd
- Luljeta Koçi Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit
- Andon Kodraliu Komuna Lunik, Librazhd
- Bajram Kullolli Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Librazhd
- Xhelal Kurti Komuna Stëblevë, Librazhd
- Liri Leka OJQ "Shoqata e Grave", Librazhd
- Sonila Marku Instituti i Gjeologjisë, Tiranë
- Alsida Myrtaj OJQ "Për një Shqipëri të Shëndetshme", Elbasan
- Mirjam Ndini Instituti i Gjeologjisë, Tiranë
- Xhek Nezha Komuna Qukës, Librazhd
- Arben Pambuku Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Tiranë
- Bledar Pepa Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit
- Ornela Poçi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Librazhd
- Lavdim Qoshi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Librazhd
- Bujar Rira Komuna Rrajcë, Librazhd
- Vasjar Shermadhi Ministria e Mjedisit (Inspektor i Peshkimit-Elbasan)
- Surja Shkurti Komuna Stëblevë, Librazhd
- Spase Shumka OJQ "PPNEA"
- Rasim Teoshku Komuna Lunik, Librazhd

Procesi i planifikimit

Duke qenë plani i parë i menaxhimit i përgatitur për këtë zonë, ishte e nevojshme që të bëheshin përpjekje të mëdha për të mbledhur informacionin bazë ekzistues. U realizuan gjithashtu edhe studime kërkimore nga specialistët për marrjen e të dhënave të reja. Këto përfshinë identifikimin dhe analizën e grupeve të interesit, burimeve ujore, komuniteteve bimore dhe habitateve, faunës (veçanërisht gjitarët dhe shpendët) dhe karakteristikave socio-ekonomike.

U organizua një seri prej katër seminaresh planifikimi me grupet lokale të interesit. Qëllimi i këtyre takimeve ishte zhvillimi i një Sistemi për Mbështetjen e Vendimeve (SMV, shih Shtojcën 2) për PKSHJ-në, si edhe shfrytëzimi i këtij instrumenti për kryerjen e një analize sistematike të sistemeve ekologjike dhe socio-ekonomike të Parkut, dhe mbi këtë bazë, identifikimi i veprimeve të menaxhimit.

U përgatit një kuptim dhe përshkrim paraprak i PKSHJ-së në bazë të njohurive lokale dhe i mbështetur nga të dhënat ekzistuese. Kjo u realizua fillimisht në formën e matricave të sistemit (seminari 1) dhe pastaj diagrameve të sistemit (seminari 2). Më pas, u bë identifikimi i treguesve për të gjithë komponentët e sistemit, dhe modeli u pajis me të dhënat ekzistuese, të gjitha me gjeo-referenca, për të siguruar një SMV operativ. Grupet e interesit të përzgjedhura u trajnuan për përdorimin e SMV-së. Qëllimi i seminarit të tretë ishte identifikimi dhe vlerësimi i vlerave potenciale dhe i kërcënimeve; formulimi i vizionit dhe objektivave të Parkut dhe përdorimi i SMV-së për identifikimin e veprimeve të mundshme të menaxhimit. Pas hartimit të një projekt-plani financiar, ishte e mundur të ofrohej drafti i parë i plotë i planit të menaxhimit. Projekt-plani u rishikua dhe u përpunua gjatë seminarit të katërt dhe të fundit, dhe më pas u përditësua duke siguruar një version të draftit përfundimtar. Hollësitë e këtij procesi paraqiten në Tabelën 1.

Pritet që instrumentet dhe metodologjia e SMV-së të përgatitura për planifikimin dhe menaxhimin e PKSHJ-së (dhe gjatë së njëjtës periudhe edhe për Peizazhin e Mbrojtur të Lumit Buna në kuadrin e të njëjtit projekt) të përdoren nga Agjencia e re e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë për menaxhimin e të gjithë rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura (Shih Shtojcën 2 për një vështrim të përgjithshëm të plotë në lidhje me teknologjinë dhe metodologjinë e SMV-së).

Tabela 1. Procesi i ndjekur për hartimin e planit të menaxhimit.

Hapi/Veprimtaria	Koha	Produkti
1. PËRGATITJA		
Planifikimi fillestar	Shtator-Tetor 2011	Plani i përgjithshëm i punës i projektit
2. MBLEDHJA E TË DHËNAVE		
Analiza e grupeve të interesit	Tetor-nëntor 2011	Raporti për grupet e interesit dhe kapacitetin institucional
Shqyrtimi i të dhënave ekzistuese, mbledhja e të dhënave në terren dhe analiza e të dhënave	Nëntor 2011 – Nëntor 2013	Raportet teknike
3. ZHVILLIMI I SISTEMIT PËR MBËSHTETJEN E VENDIMEVE (SMV)		
Seminari i parë me grupet e interesit	Janar 2012	Përshkrimi i sistemit në formën e matricave të sistemit
Seminari i dytë me grupet e interesit	Shkurt 2012	Modeli i sistemit në formën e diagrameve të sistemit
Trajnimi për zhvillimin dhe përdorimin e SMV-së	Prill 2012	8 grupe interesi u trajnuan për të përdorur SMV-në
Identifikimi i treguesve nga ekspertët teknikë dhe përfshirja e të dhënave të GIS-it	Qershor 2012	SMV e plotë dhe operacionale për PKSHJ-në
4. VLERËSIMI DHE IDENTIFIKIMI I VEPRIMEVE TË MENAXHIMIT		
Seminari i tretë me grupet e interesit	Nëntor 2012	Analiza shkak-pasojë duke përdorur SMV-në që rezulton në identifikimin e veprimeve të menaxhimit
Sinteza e rezultateve të arritura deri në këtë pikë	Maj 2013	Projekt-plani i menaxhimit
5. HARTIMI I PLANIT FINANCIAR		
Përlllogaritja fillestare e afateve kohore dhe buxheteve për veprimet e menaxhimit	Nëntor 2013	Projekt-plani financiar
Drafti i dytë i planit të menaxhimit	Dhjetor 2013	Drafti i përditësuar i planit të menaxhimit
6. FINALIZIMI		
Seminari i katërt me grupet e interesit- rishikimi i projekt-planit të menaxhimit	Shkurt 2015	Drafti përfundimtar i planit të menaxhimit duke përfshirë rezultatet e seminarit. Duhet theksuar që, për shkak të kufizimeve administrative, projekti mbeti pezull nga Janar 2014-Shkurt 2015 dhe si pasojë u desh të pezullohej edhe procesi për përgatitjen e planit të menaxhimit.
Paraqitja zyrtare e Planit të Menaxhimit të MM/AKZM-ja.	Nëntor 2015	Teksti përfundimtar i paraqitur të MM/AKZM për ndjekjen institucionale.

Qëllimi dhe përdorimi i planit

Struktura aktuale operacionale e PKSHJ-së në thelb merret me detyra administrative dhe mbikëqyrëse të zakonshme, duke u fokusuar pak te monitorimi dhe menaxhimi i burimeve natyrore dhe kulturore të parkut. Me qëllim plotësimin e kësaj mangësie, Plani trajton monitorimin dhe menaxhimin e vlerave ekologjike të Parkut dhe, kështu, ai nuk mbulon shërbimet administrative që tashmë ofrohen, veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave.

Më konkretisht, duke u mbështetur në vlerësimet dhe analizat socio-ekonomike të paraqitura në pjesët 1 dhe 2:

- Në pjesën 3 përshkruhen programet e monitorimit për vlerat natyrore dhe kulturore të zonës së mbrojtur, si edhe identifikohen një sërë masash monitorimi për përmirësimin e efektshmërisë së zonës së mbrojtur në ruajtjen e burimeve natyrore përbërëse dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm rural lokal;
- Në pjesën 4 jepen përlllogaritjet/preventivat për burimet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për funksionimin e programit të monitorimit dhe zbatimin e masave të përmendura më sipër;
- Në pjesën 5 paraqiten mënyrat dhe metodat për vlerësimin e ecurisë së zbatimit të planit;
- Në pjesën 6 renditen referencat bibliografike të konsultuara gjatë procesit të planifikimit;
- Në pjesën 7 përfshihen 10 shtojca që ofrojnë:
 1. dokumentacion të hollësishëm në lidhje me metodat, instrumentet dhe fazat e procesit të planifikimit,
 2. të dhëna dhe informacion që materializojnë analizën e paraqitur në pjesët 2 dhe 3 (të cilat janë përfshirë dhe mund të konsultohen gjithashtu nëpërmjet SMV-së),
 3. programin e hollësishëm të monitorimit dhe protokollet operacionale përkatëse.

Së pari, plani ka për synim të shërbejë si:

- një dokument reference dhe instrument për të drejtuar, siguruar vijimësinë dhe vlerësuar performancën e menaxhimit të parkut nga Zyra Rajonale (DSHP Elbasan);
- një dokument i paraqitur në mënyrë profesionale që mund të përdoret për të gjetur burime financimi për zbatimin, dhe për të siguruar që këto fonde të alokohen me efikasitet dhe efektshmëri;
- një mjet komunikimi dhe edukimi në lidhje me Parkun.

Plani gjithashtu do të kontribuojë në integrimin e PKSHJ në rrjetin ekologjik kombëtar (RREK) dhe Rrjetit më të gjerë Ekologjik të Rajonit të Ballkanit (BREN) që po krijohet aktualisht.

Audienca e synuar

Plani së pari i drejtohet personelit të administratës drejtpërdrejt përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të PKSHJ-së, së bashku me Komitetin e Menaxhimit të PKSHJ-së dhe MM-në. Audiencia të tjera të synuara përfshijnë partnerët lokalë si banorët dhe përdoruesit e burimeve në park; personelin administrativ të komunave përkatëse; anëtarët e administratave rajonale dhe agjencive teknike; Agjencinë Rajonale Mjedisore Elbasan; ministri, institute dhe OJQ të tjera të përfshira në planifikimin hapësinor dhe menaxhimin e burimeve natyrore të këtij rajoni; si edhe partnerët potencialë teknikë dhe financues.

Kohëzgjatja dhe programi i rishikimit

Plani synon të mbulojë një periudhë 10 vjeçare nga viti 2016 deri në vitin 2025. Efektshmëria e veprimeve të menaxhimit do të monitorohet dhe vlerësohet zyrtarisht çdo vit, si pjesë e procesit të përgatitjes së çdo plani vjetor pune pasues. Kjo do të ofrojë mundësi të rregullta për përditësimin dhe ndryshimin e planit fillestar të menaxhimit, dhe për të siguruar që ai të vazhdojë të jetë në koherencë me vizionin, objektivat dhe kontekstin lokal të PKSHJ-së.

PKSHJ-ja është një park i krijuar relativisht kohët e fundit dhe hartimi i këtij plani është përpjekja e parë konkrete drejt krijimit të menaxhimit operacional të plotë të kësaj zone të mbrojtur të mbështetur nga një

sasi e konsiderueshme e të dhënave sasiore. Kësisoj ky plan përfshin një numër të madh veprimesh menaxhimi të cilat synojnë rritjen e mëtejshme të njohurive për dinamikën përkatëse mjedisore dhe socio-ekonomike. Rezultatet e studimeve mund të çojnë në identifikimin e veprimeve të reja të menaxhimit që do të përfshihen në plan kur të bëhen përditësimet dhe ndryshimet e sipërpërmendura të planit.

Zbatimi i planit: programimi vjetor dhe ai shumëvjeçar

Ekipi i menaxhimit të Parkut duhet të hartojë programet vjetore dhe shumëvjeçare të veprimtarive duke përcaktuar detyrat, ngjarjet dhe synimet specifike që kërkohen për realizimin e veprimeve të planit të menaxhimit. Programet e punës duhet të përcaktojnë një program apo axhendë koherente dhe të organizuar të angazhimeve (duke përfshirë angazhimet e aktorëve të tjerë përveç administratës së Parkut), instrumentet dhe/ose veprimtaritë që shtjellojnë më tej dhe zbatojnë çdo veprim të menaxhimit.

Struktura e Planit

Plani është strukturuar sipas formatit standard të planeve të menaxhimit që u miratua së fundmi nga MM-ja për të gjitha zonat e mbrojtura në Shqipëri. Plani përfshin krerët e mëposhtëm kryesorë:

- Hyrje
- Përmbledhje
- Pjesa 1: Përshkrimi i zonës
- Pjesa 2: Vlerësimi i zonës së mbrojtur dhe i kuadrit institucional
- Pjesa 3: Menaxhimi i zonës së mbrojtur
- Pjesa 4: Plani financiar
- Pjesa 5: Monitorimi dhe vlerësimi i menaxhimit
- Pjesa 6: Referencat / Bibliografia
- Pjesa 7: Shtojcat.

PJESA 1: PËRSHKRIMI I ZONËS

Ky seksion ofron një informacion përmbledhës në lidhje me vendndodhjen dhe kontekstin e PKSJJ-së, kuadrin ekzistues rregullator dhe institucional si edhe një vështrim të përgjithshëm të sistemit që do të menaxhohet. Hartat shoqëruese paraqiten në Shtojcën 1, dhe informacioni i mëtejshëm i hollësishëm në lidhje me SMV-në dhe aspektet specifike të sistemeve natyrore dhe socio-ekonomike jepet në Shtojcat 2-10.

1.1 Vendndodhja dhe Konteksti

Vendndodhja dhe Kufijtë. Vendndodhja dhe kufijtë e PKSJJ-së përshkruhen në VKM-në Nr. 640, datë 21.05.2008 (Shtojca 3). Parku përfshin një shirit të çrregullt toke afërsisht 30 km të gjatë në drejtimin veri-jug dhe 3-12 km të gjerë në drejtimin lindje-perëndim, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 33.928 ha. Parku ndodhet mes kufirit me Maqedoninë (në lindje), në veri, rruga që të çon nga Stëbleva në Librazhd; pastaj nga Librazhdi në juglindje për në Përrenjas; dhe nga Përrenjasi përsëri në kufirin me Maqedoninë (Harta 1). Koordinatat e pikës qendrore të parkut janë: 24,4° gjatësi gjeografike dhe 41,2° gjerësi gjeografike.

Administrata Vendore. Pjesa më e madhe e PKSJJ-së gjendet në Bashkinë Librazhd të Qarkut Elbasan, ndërsa pjesa veriore përfshihet në bashkinë Bulqizë të Qarkut Dibër (Harta 2). Parku përfshin pjesë nga shtatë njësi bashkiake: Trebisht dhe Stëblevë in Bashkinë Bulqizë dhe Lunik, Librazhd Qendër, Hotolisht, Qukës dhe Rrajcë në Bashkinë Librazhd.

Të dhëna të hollësishme u siguruan për gjashtë nga shtatë njësitë bashkiake, me përjashtim të Trebishtit në skajin verior. Së bashku këto gjashtë njësi bashkiake kanë një popullsi të përgjithshme të regjistruar 46.258 banorë, duke përfshirë 11.626 familje të vendosura në 51 fshatra; dhe mbulojnë një sipërfaqe të përgjithshme prej 76.989 ha, duke përfshirë 6.996 ha tokë të kultivuar, 11.641 ha tokë bujqësore dhe 16.746 ha tokë pyjore komunale (Tabelat 3 dhe 4). Nuk u arrit të përftoheshin të dhëna të veçanta për fshatrat, popullsinë dhe llojet e ndryshme të tokës brenda PKSJJ-së.

Tabela 3. Hollësitë e përmbledhura për gjashtë nga shtatë njësitë bashkiake që kontribuojnë te PKSJJ-ja.

Njësia bashkiake	Numri i fshatrave	Numri i familjeve	Popullsia	Toka e kultivuar (ha)	Toka bujqësore (ha)	Toka pyjore komunale (ha)	Sipërfaqja e përgjithshme e tokës (ha)
Stëblevë	7	534	2102	406	1276	1800	11884
Lunik	7	869	4180	718	1249	2470	10841
L. Qendër	12	2833	11354	1904	3028	4637	17531
Hotolisht	8	1932	7104	909	1465	3688	17610
Qukës	11	2829	10879	1832	2881	N/A	12388
Rrajcë	7	2629	10639	1227	1742	4151	6735
TOTALI	51	11626	46258	6996	11641	16746	76989

Tabela 4. Lista e fshatrave të gjashtë nga shtatë njësitë bashkiake që kontribuojnë te PKSJJ-ja.

Njësia bashkiake	Fshatrat
Stëblevë	Borova, Llanga, Moglica, Prodani, Sebishti, Stëbleva dhe Zabzuni
Lunik	Dranovicë, Kosharisht, Kostenjë, Letem, Lunik, Prevallë dhe Zgosht
Librazhd Qendër	Arrëz, Babje, Dorez, Dragostunje, Gizavesh, Kuturman, Librazhd-Katund, Librazhd-Qendër, Marinaj, Qarrishtë, Spathar dhe Togëz

Hotolisht	Buzgarë, Dardhë, Hotolisht, Kokrevë, Vehcan, Vulcan, dhe Xhyra
Qukës	Bërzheshtë, Dritaj, Fanjë, Gurrë, Karkavec, Mënik, Pishkash, Pishkash-Veri, Qukës-Shkumbin, Qukës Skënderbej dhe Skroskë
Rrajcë	Bardhaj, Katjec, Kotodesh, Rrajcë, Skënderbej, Sutaj dhe Urakë

Zonat Fqinjje. Zonat fqinjje përfshijnë pjesët e mbetura të shtatë komunave përbërëse dhe, në lindje, pjesën ngjitur të Maqedonisë.

Konteksti Rajonal. Librazhdi, qendra e rrethit, është një qytet i vogël që shtrihet 80 km në lindje të Tiranës dhe 21 km në lindje të Elbasanit (qendra e Qarkut) përgjatë rrugës kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare që lidh Tiranën me Shkupin. Nga Librazhdi, rreth 43 km më tej ndodhet Përrenjasi, qyteti i dytë më i madh i rrethit (Shtojca 1, Harta 6). Historikisht, nxjerrja e mineraleve si xeherori i kromit dhe hekur-nikelit ka qenë veprimtaria kryesore ekonomike e rrethit. Sidoqoftë, që nga vitet 1990 shumë nga minierat janë mbyllur, për shkak të paaftësisë për të përmbushur standardet moderne evropiane mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë, duke pasur një ndikim shumë negativ në jetën e banorëve të Librazhdit dhe Qarkut të Elbasanit. Industria më e madhe, për shembull, ishte fabrika e çelikut në Elbasan. Kjo u ndërtua dhe u vu në funksionim nga shteti gjatë periudhës komuniste, por tani funksionon me një kapacitet shumë të kufizuar duke përpunuar metalet e ricikluara. Ka edhe një fabrikë çimentoje në Elbasan. Është ndërtuar një rrugë e re që lidh Tiranën me Elbasanin nëpërmjet një tuneli të gjatë e cila po përfundon aktualisht. Kjo do të zvogëlojë ndjeshëm largësinë dhe kohën për të vajtur në Elbasan dhe, së bashku me përmirësimin aktual të rrugës Librazhd-Stëblevë, do të përmirësojë ndjeshëm aksesin nga Tirana në Park, dhe kështu edhe mundësitë për zhvillimin e turizmit dhe veprimtarive të tjera ekonomike në Park.

Lidhja me Rrjetin Kombëtar Ekologjik. PKSHJ-ja është një nga 798 zonat e mbrojtura ekzistuese në Shqipëri. Shumica e tyre përfshijnë monumente natyrore me shtrirje të kufizuara (n = 750). Ekzistojnë 55 zona të mbrojtura më të gjera që mbulojnë një sipërfaqe të përgjithshme prej 435.795 ha (Harta 4). PKSHJ-ja është një nga 14 Parqet Kombëtare, por përbën 18% të sipërfaqes së përgjithshme të parqeve kombëtare, dhe 8% të sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura në Shqipëri. Brenda Qarkut të Elbasanit ndodhen edhe gjashtë zona të tjera të mbrojtura (Dardhë-Xhyrë, Kuturman, Polis, Qafë-Bushi, Sopot dhe Stravaj), dhe që të gjitha janë rezerva natyrore të menaxhuara, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5.245 ha. Me përjashtim të Qafë-Bushit (500 ha) pjesa tjetër shtrihen të gjitha në Rrethin e Librazhdit.

PKSHJ-ja ka një pozicion strategjik dhe ofron lidhje potencialisht të rëndësishme me Peizazhin e Mbrojtur të Pogradecit në jug; me rrjetin e zonave të mbrojtura të Maqedonisë në lindje; me Rezervën Natyrore të sapa shpallur Korab-Koritnik në veri; dhe në përfundim me një kompleks të afërt të zonave të mbrojtura në Shqipërinë Qendrore që përfshijnë Parkun Kombëtar të Malit të Dajtit, Parkun Kombëtar të Qafështamës dhe Peizazhin e Mbrojtur të Malit me Gropa- Bizë-Martanesh.

Pjesa veriore e Parkut derdhet në Lumin Drin, ndërsa pjesa më e madhe e mbetur derdhet në lindje në Lumin Shkumbin (Harta 5). Shkumbini kalon në Librazhd dhe Elbasan para se të futet në Detin Adriatik në Gjirin e Karavastasë. Laguna e Karavastasë është një ligatinë dhe zonë e rëndësishme shpendësh dhe është shpallur Park Kombëtar dhe Zonë Ramsar.

Kontributi të Rrjetit Ekologjik Ndërkombëtar. PKSHJ-ja është identifikuar si një nga 45 Zonat e Rëndësishme Bimore (ZRB) dhe si një nga 25 Zonat Emerald Potenciale në Shqipëri (Tabela 5). Pjesa ngjitur e Jabllanicës në Maqedoni është identifikuar gjithashtu si një ZRB, si një zonë qendrore e Rrjetit Kombëtar Ekologjik të Maqedonisë, dhe si një zonë prioritare për zgjerimin e rrjetit ekzistues të zonave të mbrojtura në Maqedoni. Ka të ngjarë që në të ardhmen PKSHJ-ja të jetë pjesë e një zone të mbrojtur ndërkufitare shumë më të madhe. PKSHJ-ja do të kontribuojë gjithashtu edhe në zhvillimin e Rrjetit Ekologjik të Rajonit të Ballkanit (BREN), në Brezin e Gjellbër Evropian dhe në Rrjetin Ekologjik Pan-Evropian (PEEN). Ai gjithashtu kontribuon në zonat e ruajtjes me prioritet global të njohura nga WWF-ja (Ekorajonet Globale 200) dhe FKPE-ja (Pikat e Nxehta dhe Zonat Kryesore të Biodiversitetit).

Tabela 5. Kontributi i PKSHJ-së në rrjetet ekologjike ndërkombëtare.

Rrjeti Ndërkombëtar	Shënime
Zonë e Rëndësishme Bimore (ZRB)	Rrjeti ndërkombëtar i zhvilluar Plantlife International. PKSHJ-ja është një nga 45 ZRB-të e identifikuar në Shqipëri (AL08 - Rrajcë - Shebenik - Jabllanicë)
Rrjeti Emerald/ Rrjeti Natura 2000	Rrjete evropiane; Natura2000 përfshin vende anëtare të BE-së dhe vende të Rrjetit Emerald që nuk janë pjesë e BE-së. PKSHJ-ja është pjesë e një nga 25 zonave potenciale Emerald të identifikuar në Shqipëri (AL0000022 – Parku Kombëtar Rrajcë-Shebenik / Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë; 25.000 ha)
Zonë Ndërkufitare e Ruajtjes	Pjesa ngjitur e Jabllanicës në Maqedoni është identifikuar si një ZRB, si një zonë qendrore e Rrjetit Kombëtar Ekologjik të Maqedonisë, dhe si një zonë prioritare për zgjerimin e rrjetit ekzistues të zonave të mbrojtura në Maqedoni
Rrjeti Ekologjik i Rajonit të Ballkanit (BREN)	PKSHJ-ja është pjesë e Rrjetit Ekologjik të Rajonit të Ballkanit që po zhvillohet
Brezi i Gjelbër Evropian	Rrjeti Evropian përgjatë rrugës së ish-perdes së hekurit, i bashkërenduar nga Shoqata e Brezit të Gjelbër Evropian. PKSHJ-ja është pjesë e Brezit të Gjelbër Ballkanik dhe Evropian
Ekorajonet Globale 200 të WWF-së	Rrjet global. PKSHJ-ja kontribuon në dy Ekorajone Prioritare Globale 200 të identifikuar nga WWF-ja, respektivisht: Ekorajoni 123 (Pyjet, Zonat Pyjore dhe Shkurret Mesdhetare) dhe Ekorajoni 180 (Lumenjtë dhe Përrenjtë me Ujë të Ëmbël Ballkanikë)
Pikat e nxehta globale të FKEP/CEPF dhe Zonat Kryesore të Biodiversitetit (ZKB)	Rrjet global. Shqipëria është pjesë e Korridorit Jugperëndimor të Ballkanit që u identifikua si një nga gjashtë korridoret prioritare brenda Pikës së Nxehtë prioritare të Pellgut të Mesdheut.

1.2 Kuadri Rregullator dhe Institucional

1.2.1 Statusi Ligjor

Krijimi, menaxhimi dhe shfrytëzimi i zonave të mbrojtura në Shqipëri rregullohen nga Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar më pas nga Ligji Nr. 9868 datë 4.02.2008. PKSHJ-ja u krijua në bazë të këtij Ligji me VKM-në Nr. 640, datë 21.05.2008 (Shtojca 2). Ky VKM përcakton statusin, vendndodhjen, sipërfaqen dhe kufijtë e Parkut; përshkruan një model të thjeshtë zonimi të Parkut dhe nivelet përkatëse të mbrojtjes për çdo zonë; cakton përgjegjësitë e MM-së për menaxhimin e Parkut; dhe kërkon që MM-ja në bashkëpunim me grupet e tjera të interesit të hartojë një projekt-pan menaxhimi brenda një viti nga krijimi i Parkut. Nuk jepen motivacione për krijimin e PMLB-së.

Në Tabelën 6 jepen hollësi për katër zonat e përshkruara të menaxhimit, duke përfshirë zonën qendrore, zonën e përdorimit të qëndrueshëm, zonën e rekreacionit dhe atë të përdorimit tradicional. Shtrirja e këtyre zonave paraqitet në Hartën 6 dhe përshkrimet e niveleve përkatëse të mbrojtjes për çdo zonë jepen me hollësi në Shtojcën 4.

Parqet Kombëtare në Shqipëri në përgjithësi ofrojnë Nivelin 2 të mbrojtjes dhe në këtë bazë janë njësuar me Kategorinë II të zonave të mbrojtura të IUCN-në. Sidoqoftë, sipas IUCN-së të paktën 75% e sipërfaqes së zonës së mbrojtur duhet të menaxhohet si "Park Kombëtar". Sa i takon PKSHJ-së vetëm 56% e sipërfaqes së tij është shpallur si Niveli 1 dhe 2 i mbrojtjes, me një gamë më të gjerë përdorimesh që lejohen në pjesën tjetër të tij.

Tabela 6. Zonat e shpallura të menaxhimit për PKSJJ-në.

Zona	Niveli i mbrojtjes	Sipërfaqja (ha)	% e sipërfaqjes së përgjithshme	% kumulative
Qendrore	Niveli 1	14.046	41	41
E përdorimit të qëndrueshëm	Niveli 2	5.253	15	56
E rekreacionit	Niveli 3	2.209	7	63
E përdorimit të qëndrueshëm	Niveli 4	12.420	37	100
Gjithsej		33.298	100	

1.2.2 Politikat dhe Legjislacioni

Listat e strategjive dhe planeve kombëtare që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve natyrore, së bashku me legjislacionin mjedisor dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në marrëveshje mjedisore shumëpalëshe jepen në Shtojcën 5. Ato me rëndësi më të madhe për zhvillimin dhe menaxhimin e PKSJJ-së renditen në Tabelën 7.

Tabela 5. Marrëveshjet ndërkombëtare rajonale dhe ndër-rajonale, strategjitë kombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore dhe planet vendore që kanë të bëjnë me PKSJJ-në.

Marrëveshjet, Politikat, Strategjitë, Legjislacioni, Planet
MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE
Mbrojtja e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore (UNESCO)
Tregtia ndërkombëtare e llojeve të rrezikuara të faunës së egër (Konventa CITES)
Ruajtja e llojeve shtegtare të kafshëve të egra (Konventa e Bonit), duke përfshirë lakuriqët e natës dhe shpendët e ujit shtegtarë të Afrikës dhe Euroazisë (AEWA)
Konventa për Diversitetin Biologjik (CBD)
Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)
Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Shkretëtirëzimit (UNCCD)
MARRËVESHJE RAJONALE DHE NDËR-RAJONALE
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike
Ruajtja e Faunës së egër dhe Mjedisit Natyror Evropian (Konventa e Bernës)
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar
Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare
Konventa Evropiane për Peizazhin
STRATEGJITË KOMBËTARE TË SHQIPËRISË
Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin 2015-2020 (që nga muaji Janar 2015 ende në KM për miratim)
Energjia (2002)
Pyjet dhe kullotat (2004)
Strategjia e dytë kombëtare e mjedisit (2006)
Ligatinat (2006)
Strategjia ndërsektoriale e mjedisit (2007)
Bujqësia dhe ushqimi (2007)
Zhvillimi ndërsektorial rural (2007)
Transporti (2008)
Turizmi (2008)
Zhvillimi dhe integrimi (2008)
Menaxhimi i mbetjeve (2011), dhe
Shërbimet e Ujësjellës –kanalizimeve (2011)
LEGJISACION I RËNDËSISHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Marrëveshjet, Politikat, Strategjitë, Legjislacioni, Planet
Burimet ujore, Nr. 8093 (1996)
Privatizimi i hidrocentraleve lokale, Nr. 8527 (i ndryshuar) (1999)
Zonat e mbrojtura, Nr. 8906 (2002), i ndryshuar
Mbrojtja e mjedisit, Nr. 10431, qershor 2011
Sektori i energjisë elektrike, Nr. 9072 (2003)
Mbrojtja e liqeneve ndërkufitare, Nr. 9103 (2003)
Pyjet dhe shërbimi pyjor, Nr. 9385 (2005) [Sipas Ligjit për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor (Nr. 9385) 2005, organet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve; krijimin e organeve administrative dhe teknike për kryerjen e inventarëve pyjorë; dhe përgatitjen e planeve për financimin e investimeve në pyje].
Mbrojtja e biodiversitetit, Nr. 9587 (2006), i ndryshuar
Mbrojtja e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare, Nr. 9700 (2007)
Ujitja dhe kullimi, Nr. 9860 (2008)
Tregtia ndërkombëtare e llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër, Nr. 9867 (2008), i ndryshuar
Mbrojtja e faunës së egër, Nr. 10006 (2008)
Planifikimi i territorit, Nr. 10119 (2009)
Shëndeti publik, Nr. 10138 (2009)
Gjuetia, Nr. 10253 (2010)
Minierat, Nr. 10304 (2010)
Vlerësimi i ndikimit në mjedis, Nr. 10440 (2011)
Lejet mjedisore, Nr. 10448 (2011)
Menaxhimi i integruar i mbetjeve, Nr. 10463 (2011)
AKTET NËNLIGJORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Transferimi i pyjeve dhe kullotave komunale nën përdorimin dhe administrimin e bashkive dhe komunave (1996)
Lista e Veprimtarive me Ndikim në Mjedis për të cilat nevojitet një Leje Mjedisore Nr. 805 (2003)
Funksionimi i Inspektoratit të Mjedisit, Nr. 24 (2004)
Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrjen Mjedisore, Nr. 994 (2008)
Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit Nr. 1189 (2009)
Organizimi dhe Funksionimi i Agjencisë Rajonale Mjedisore, Nr. 2 (2010)
Shpërndarja e Funksioneve të Inspektimit dhe Funksioneve Teknike të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Lejeve dhe Monitorimit Mjedisor në Agjencitë Rajonale Mjedisore, Nr. 139 (2011)
PLANET LOKALE
Plani i Veprimit për Turizmin në Elbasan (2009)
Plani Strategjik 2012-2016 për qarkun Elbasan (Draft, 2012)
Plani i menaxhimit të pyjeve për Rrajcën (1982)
Plani i menaxhimit të pyjeve për Qarrishtën(2001)
Plani i menaxhimit të pyjeve për Stëblevë-Letem (2003)

1.2.3 Grupet e Interesit

Grupet kryesore të interesit për PKSHJ–në përfshijnë qeverinë qendrore, veçanërisht Drejtorinë e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura në MM, AKZM–në, Autoritetet Rajonale të Elbasanit, Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit, Agjencinë e Basenit Ujor të Lumit Shkumbin, autoritetet e Bashkisë Librazhd, Autoritetet e Njërive Bashkiake, OBK-të dhe OJQ-të dhe sektorin privat, sikurse tregohen në Tabelën 8.

Tabela 8. Grupet e interesit që kanë lidhje me menaxhimin e PKSHJ-së.

Niveli	Vendndodhja	Grupet e interesit
Qeveria qendrore	Tiranë	MM-ja (Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura)
Niveli qendror dhe Qarqet	Tiranë	AKZM-ja, zyra qendrore ARZM-ja, zyrat rajonale
Autoritetet Rajonale Elbasan	Elbasan	Këshilli i Qarkut Zyra e Zhvillimit Rajonal Agjencia Mjedisore Rajonale Drejtoria Bujqësore Rajonale
Institucionet mbështetëse rajonale	Elbasan	Agjencia e basenit ujqor të Lumit Shkumbin Universiteti "Aleksandër Xhuvani"
Autoritetet e Bashkisë Librazhd	Librazhd	ARZM-ja Drejtoria e Bujqësisë Drejtoria Arsimore Drejtoria e Shërbimit Publik
Administrata Vendore		Bashkia Librazhd Administratat e secilës prej komunave pjesëmarrëse
OBK-të- Rrethi Librazhd	Librazhd	Shoqata e Gjuetarëve Librazhd Shoqata e Grave Shoqata e Pyjeve Komunale Shoqata "Lilium Albanicum"
OBK-të- Njësitë Bashkiake/ Fshati	Qarishtë	Shoqata "Qarishta"
	Fushe Studë	Shoqata "Aurora"
OJQ-të kombëtare	Tiranë	PPNEA World Vision – Dega Librazhd OJQ "Për një Shqipëri më të Shëndetshme"
OJQ-të lokale	Librazhd	Dorez
Sektori privat	Librazhd	Operatorët e hidrocentraleve Operatorët e minierave Operatorët turistikë Fermierët/barinjët Mbledhësit e produkteve pyjore jo-drusore

1.2.4 Kuadri i Qeverisjes dhe Menaxhimit

Institucionet kryesore që kanë rol të drejtpërdrejtë në menaxhimin e PKSHE-së përfshijnë MM-në, nëpërmjet Drejtorisë së saj të Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (DBZM), AKZM-në, Komitetin e sapo krijuar të Menaxhimit të PKSHE-së dhe Bashkitë.

MM-ja. Në vitin 2005, kompetencat për zonat e mbrojtura i kaluan MM-së, meqë kishte më shumë lidhje me çështjet e mbrojtjes së natyrës. Zonat e mbrojtura aktualisht janë përgjegjësi e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Mjedisore të MM-së, më konkretisht e dy drejtorive teknike të saj, Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (DBZM) dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave (DPK).

AKZM-ja. E krijuar në shkurt 2015, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk ekzistonte gjatë kohës së përgatitjes së këtij plani. Që nga krijimi i saj, AKZM-ja është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, që realizohet nëpërmjet agjencive të saj të zbatimit, 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM). Çdo administratë rajonale ka një drejtor dhe është e strukturuar në dy sektorë: menaxhimi dhe monitorimi. Sektori i menaxhimit përbëhet nga një numër specialistësh (2-4) përgjegjës për të gjitha çështjet e menaxhimit që kanë të bëjnë me të gjitha zonat e mbrojtura brenda

rajonit. Sektori i monitorimit përbëhet nga një numër rojesh mjedisore të caktuara në ZM të ndryshme brenda rajonit. AKZM-ja ka një staf prej 20 punonjësish në Tiranë dhe 204 punonjës në nivel rajonal.

Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura. DBZM-ja është përgjegjëse për mbrojtjen e habitateve dhe ekosistemit natyror, zonave të mbrojtura dhe monumentet natyrore, si edhe për ruajtjen e llojeve të florës dhe faunës së egër. DBZM-ja përbëhet nga dy sektorë tematikë, Sektori i Zonave të Mbrojtura dhe Sektori i Biodiversitetit. DBZM-ja ka një numër total prej 7 punonjësish duke përfshirë edhe Drejtorin, 2 përgjegjës njësisht dhe dy specialistë në çdo njësi. Roli i DBZM-së kufizohet në hartimin e legjislacionit për zonat e mbrojtura dhe politikave për zhvillimin dhe forcimin e rrjetit kombëtar ekologjik; zhvillimin e zonave të rrjetit Emerald dhe Ramsar; dhe identifikimin e ZRB-ve dhe ZRSH-ve si edhe Zonat e Veçanta të Ruajtjes (ZVR-të) dhe Zonat e Veçanta të Mbrojtjes (ZVM-të).

Komiteti i Menaxhimit i PKSHJ-së. Sipas Vendimit të Qeverisë të vitit 2005 për Komitetet e Zonave të Mbrojtura, të gjitha zonat e mbrojtura të kategorisë II dhe IV duhet të kenë një komitet menaxhimi vendor, si mekanizëm për të lehtësuar pjesëmarrjen e grupeve të interesit, si përfaqësuesit e qeverisjes vendore, komunitetet, pronarët e tokave, OJQ-të dhe sipërmarrësit, në planifikimin e terrenit dhe menaxhim. Kjo është realizuar kohët e fundit në PKSHJ me ngritjen e një bordi menaxhimi në mars 2013.

Bashkitë dhe njësitë bashkiake. Rregullorja Nr. 308, për Transferimin e Pyjeve dhe Kullotave në Përdorim të Komunave (1996), nisi procesin e reformës së kalimit të pronësisë së pyjeve nga shteti te komunat dhe decentralizimin te një menaxhim të pyjeve me bazë në komunitet. Më vonë, Ligji për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor i vitit 2005 e zgjeroi këtë proces, duke trajtuar më konkretisht posedimin e tokës pyjore dhe të drejtat e përdorimit të pyjeve, duke përfshirë menaxhimin e pyjeve me bazë në komunitet dhe krijimin e organeve të qeverisjes së pyjeve. Mbrojtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave lokale dhe i burimeve natyrore me natyrë lokale përmendet edhe në Ligjin Nr. T8652 të vitit 2000 për Decentralizimin si funksion ekskluziv i Komunës/Bashkisë. Duke u mbështetur në këtë kuadër, ka tri lloje posedimi të pyjeve: nga shteti, qeverisja vendore dhe nga privati.

Të drejtat lokale të përdorimit jepen për një periudhë 10 vjeçare (të rinovueshme) dhe kërkojnë një plan menaxhimi që duhet të hartohet bashkërisht nga DRSHP-ja dhe Bashkia. Bashkia është përgjegjëse për menaxhimin e përdorimit të pyllit nga komuniteti lokal në përputhje me planin e menaxhimit. Në disa zona, funksionojnë Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve në bazë fshati të cilat kanë të drejta varësie përdorimi për veprimtari të tilla si kullotja dhe mbledhja e druve të zjarrit dhe bimëve, sikurse është rënë dakord. Këto shoqata grupohen në një federatë rajonale dhe përfaqësohen në nivel kombëtar nga Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale (SHKPKK). Këto nisma nga poshtë-lart institucionalizojnë shërbimet pyjore komunitare, përfaqësojnë interesat e grupeve lokale të interesit dhe luajnë një rol kundërveprues në marrëveshjet me strukturat qeveritare.

Procesi i transferimit të pyjeve te bashkitë është sidoqoftë ende i pjesshëm, në praktikë hasen shumë mangësi. Jo të gjitha bashkitë i kanë regjistruar të gjitha zonat e tyre pyjore; Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve funksionojnë në disa zona por jo kudo; komunat ankohen për mungesën e një përgjegjësie të qartë në lidhje me menaxhimin e pyjeve, veçanërisht nëse do të jetë komuna apo DSHP-ja autoriteti kryesor i vendimmarrjes në lidhje me përdorimin e burimeve pyjore; dhe të ardhurat nga përdorimi i burimeve pyjore janë të kufizuara, pjesërisht për shkak të shtrirjes së veprimtarive informale dhe të paligjshme, të tilla që komunat nuk kanë fondet e nevojshme për të zbatuar kompetencat e tyre në menaxhimin e zonave pyjore, dhe si rezultat kjo përgjegjësi është vetëm një barrë për to.

1.3 Sistemi ekologjik dhe socio-ekonomik i Parkut

Në këtë seksion jepet një vështrim i përgjithshëm përshkruar i sistemit ekologjik dhe socio-ekonomik që karakterizon Parkun Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës (PKSHJ). Ky paraqitet në formë teksti dhe diagramash përmbledhëse që tregojnë komponentët kryesorë të ekosistemit të përgjithshëm dhe shërbimet e tij, si dhe ndërlidhjet bazë. Hollësi të mëtejshme jepen në Shtojcat 6-9.

1.3.1 Vështrim i përgjithshëm

Zona e Shebenik-Jabllanicës shtrihet në një lartësi nga 300 deri 2200 metra mbi nivelin e detit (Harta 7). E pozicionuar në pjesën e brendshme të vendit, zona ka një klimë kontinentale dhe jo mesdhetare. Temperatura mesatare vjetore është 13.4° C, ndërsa reshjet arrijnë në rreth 1.360 mm në vit.

Në këtë zonë u identifikuan tre lloje tokash: kullotat natyrore (zona natyrore), mjediset ujore dhe habitatet artificiale. Kullotat natyrore ndahen në gjashtë komponentë: tre lloje pyjesh, me shkurrishte dhe shkurre të ulëta, livadhe, si dhe toka të karakterizuara me rrëshqitje toke dhe toka jo pjellore. Tre llojet kryesore të pyjeve janë pyje termofile gjetherënëse (pyjet e dushkut, kryesisht nga *Quercus frainetto* dhe *Quercus cerris* ose nga *Quercus petraea* dhe pyjet e dominuara nga *Carpinus orientalis* ose *Platanus orientalis*), pyjet halore (kryesisht të dominuar nga *Pinus nigra*, *Pinus peuce* dhe *Abies alba*) dhe pyjet mesofile gjetherënëse (pyjet e ahut të dominuara nga *Fagus sylvatica*). Pyjet e dushkut janë vendosur në zonat më të ulëta, ndërsa pyjet e ahut dhe ato halore zënë zonat më të larta (Harta 8). Livadhet gjenden kryesisht në lartësi të larta mbi vijën e pemëve.

Mjediset kryesore ujore përbëhen nga ujërat nëntokësore (burimet) dhe ujërat sipërfaqësore në formën e liqeneve, përrenjve dhe moçaleve të shpërndara (Harta 9). Gjithashtu, ka disa liqene natyrore alpine, si dhe liqene dhe pellgje artificiale të ndërtuar për qëllime ujitjeje (liqenet) dhe të prodhimit të peshkut (pellgjet). Përrenj të shumtë e kanë origjinën në PKSHJ, të cilët thahen kryesisht në lindje të lumit Shkumbin. Pjesa e skajit verior është pjesë e ujërave kryesore të Drinit të Zi.

Tokat kryesore të përpunuara përfshijnë vendbanimet/ fshatrat (ndërtesat), tokat e kulturave bujqësore (tokat bujqësore), rrugët dhe infrastrukturën e hidrocentraleve. Ka gjithashtu disa "pika të nxehta" kulturore.

Bashkësitë bimore dhe habitatet. Diversiteti i nënshtresave gjeologjike (kryesisht sedimente aluvionale, shkëmbinj gëlqerorë dhe ultrabazikë vullkanikë) dhe i karakteristikave gjeo-morfologjike, i kombinuar me pjerrësinë e madhe të lartësive dhe veprimtarinë tradicionale të vazhdueshme të njeriut janë faktorët kryesorë që ndikojnë në praninë dhe shpërndarjen e bashkësive të bimëve dhe llojeve brenda PKSHJ-së. Gjithsej, janë identifikuar dhe pasqyruar në hartë 65 lloje të bimësisë (Harta 10, Shtojca 6). Gjithashtu, 24 prej tyre janë konsideruar me rëndësi të veçantë ruajtjeje, në bazë të dy kriterëve: lidhja e tyre me habitatet e renditura në Direktivën e Habiteteve 92/43/KEE (më poshtë e referuar si D.H.) ose si një pasuri tepër e madhe e llojeve.

Në brezin kryesor të PKSHJ-së (300-1000m) gjenden tri grupe kryesore të bimësisë: bimësia bregore përgjatë luginave të ngushta në sedimentet aluvionale, pyjet termofile gjetherënëse, me livadhet dhe shkurrishtet pasardhëse, në konglomeratët dhe gurët ranorë dhe ato në shkëmbinj të vullkanikë.

Bimësia bregore mbulon një zonë të vogël dhe është e shpërndarë brenda PKSHJ-së, përgjithësisht e vendosur në gryka të thella të pandërprera. Zbuluam vetëm disa pjesëza të pyjeve të vogla të *Platanus orientalis* (Lloji 19) përgjatë disa degëve të lumit Shkumbin, ndërsa përgjatë rrjedhës së këtij lumi, pikërisht jashtë kufirit të Parkut, ato janë më të përhapura dhe më të mëdha. Këto pyllishte janë të përhapura mbi depozitimet aluvionale të pastabilizuara të lumenjve të mëdhenj, depozitimet me zhavorr apo dhera dhe gurë të përrenjve të përherëshëm apo të përkohshëm, pellgjet pranverorë, dhe në veçanti, mbi grykat e rrëpirave të thepisura me hije. Ato janë përfshirë në habitatin D.H. "92C0- pyjet *Platanus orientalis* dhe *Liquidambar orientalis*" që janë identifikuar në Greqi, Ballkanin Jugor, Siçili dhe disa ishuj të Egjeut.

Bimësia tjetër lumore që gjendet në PKSHJ është një lloj korije në rritje në zhavorret e përrenjve me regjime të larta të prurjeve në një verë alpine të dominuar nga *Salix elaeagnos* dhe/ ose *S. purpurea* (D.H: 3240 - Lumenjtë alpinë dhe bimësia e tyre drusore me *Salix elaeagnos*) që është e përhapur në luginat alpine dhe të Ballkanit.

Pyjet termofile gjetherënëse që rriten në brezin kryesor mbi shkëmbinjtë konglomeratë dhe ranorë janë pyje dhe pyllishte nën-kontinentale të tipit *termo-xerophilous Quercus frainetto-Q cerris* (Llojet 20 dhe 21), si dhe pyje dhe pyllishte të tipit *Carpinus orientalis* (Llojet 8 dhe 9). Lloji i parë klasifikohet si habitat i D.H "91M0 Pyll dushku panonian-ballkanik me qarr dhe bunge", i përshkruar për kodrat dhe fushat panonike të Rumanisë perëndimore dhe jugore, Ballkanit verior dhe Greqisë dhe Anadollit mbi-mesdhetar. Ky habitat vendoset në përgjithësi midis lartësive 300-700 m në PKSHJ. Pyjet *Carpinus orientalis* vendosen në faqet e rrëpira të kodrave konglomerate ose gëlqerore, ku shpatet e pjerrëta apo ndërprerje antropike shkaktojnë degradim të tokës dhe kushte thatësire. Të dy llojet e pyjeve janë vendosur në zonën me popullsi më të dendur dhe shpesh këto pyje degradohen për shkak të mbishfrytëzimit të tyre. Ky është dhe shkak kryesor i erozionit të tokës së kësaj zone, nga zvogëlimi i pjesës së mbuluar me pemë dhe përhapja e vazhdueshme e rrëshqitjeve të tokës. (Lloji 13).

Kontaktet e shumta të livadheve me këto pyje përbëjnë përgjithësisht një mozaik kompleks të livadheve *Molinio-Arrhenatheretea*, në tokën më të thellë dhe më të lagësht (Lloji 14) dhe kullotat e thata të stepës *Festuco-Brometea* (Lloji 15), të dyja të shfrytëzuara intensivisht për kullotë. Përgjatime të rralla përbëjnë bashkësitë bimore që kositen për mbledhjen e barit të thatë, i cili, si për shembull në fushën Fusha e Studës, mund të ketë një pasuri të konsiderueshme floristike.

Në nënshtresat vullkanike, në kontakt me brezat e lartë malorë dhe nën-alpinë, vërejmë një lloj të ndryshëm të pyjeve dhe pyllishteve termofile gjetherënëse dhe pyje të karakterizuara nga *Quercus petraea* (Llojet 22 dhe 23) që janë në një gjendje më të mirë ruajtjeje. Ato janë përhapur në Ballkanin lindor dhe jugor në vende me tokë të thellë dhe pak acidike. Këto pyje janë prerë intensivisht dhe kryesisht në PKSHJ dhe janë zëvendësuar me *Buxus sempervirens* dhe/ose bashkësi të *Juniperus oxycedrus* (Lloji 6).

Në këtë zonë, mund të gjendet edhe gurë të dalë në sipërfaqe të shkëmbinjve serpentinorë. Tokat që rrjedhin nga shkëmbinjtë serpentinorë janë toksike për shumë bimë, për shkak të niveleve të larta të nikelit, kromit dhe kobaltit që kanë. Gjithashtu, rritja e shumë bimëve frenohet edhe nga nivelet e ulëta të kaliumit dhe fosforit dhe të një treguesi të ulët të kalciumit/magnezit. Rivendosja e bimësisë pyjore në këtë tokë të varfër dhe toksike është shumë e vështirë, si rrjedhojë edhe përpjekjet e mëparshme kanë dështuar. Për më tepër, bimësia dytësore është bartëse e një flore shumë të veçantë, më të specializuar, me lloje specimesh që rriten ngadalë dhe me shpeshtësi të kufizuar si *Alyssum bertolonii*, *Festucopsis terpetine*, *Euphorbia spinosa* dhe *Sedum serpentine*.

Brezi i malit (1000-1800 metra) mbizotërohet nga pyjet me *Fagus sylvatica* dhe bashkësitë përkatëse të kullotave dhe shkurrishteve. Pyjet e ahut janë tejet të përhapur në Evropë. Këto pyje ahut të pranishëm në Shebenik (Llojet 10, 11 dhe 12) korrespondojnë me habitatin "91K0- pyjet ilire *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion)" të përshkruar për Dinaridet, me veçantinë dhe shkëlqimin e tyre në Alpet juglindore, karpitet jugperëndimore dhe kodrat e Panonikut të mesëm, ku ato konsiderohen si një qendër e rëndësishme e diversitetit të llojeve. I rëndësishëm është pylli i pacenuar *Fagus sylvatica* që rritet përgjatë Luginës së Bushtricës, në pjesën jugore të PKSHJ-së. Ai ka pemë monumentale të madhësive mbresëlënëse dhe pasuri të madhe floristike, si dhe është propozuar si një vend i trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Në periferi të pyjeve të ahut, në toka të thella dhe të pasura, mund të zhvillohen bashkësi interesante bimësh të cilat mbizotërohen nga *Geranium sylvaticum* dhe/ose *Geum rivale* (6430-bashkësi barishtesh hidrofile të larta të fushës dhe malit të niveleve alpine). Brenda pyjeve të ahut mund të gjenden sipërfaqe të vogla dhe të shpërndara me lloje të rralla dhe endemike të *Pinus peuce* ("95A0 – pyje të larta me pisha oro-mesdhetare"). Ndryshe nga ahut që mund të rritet në nënshtresa të ndryshme gjeologjike, pyllishtet *Pinus peuce* (Type 17) mund të gjenden vetëm në shkëmbinjtë gjarpërues ose shkëmbinj të tjerë ultrabazikë vullkanikë.

Në brezin e lartësive më të mëdha (1800-2250m), mbi vijën e pemëve, mund të gjenden dy lloje të ndryshme të tokës, njëra me përbërje gëlqerore dhe tjetra me shkëmbinj vullkanikë. Në shkëmbinj vullkanik, në qendrën e PKSH-së, rreth majave më të larta të Shebenikut peizazhi mbizotërohet nga një mozaik i kullotave të *Sesleria coerulans* ("livadhet acidofile 62D0-oro-mesiane") me shqopishte shkurresh të shkurtra të *Erica carnea* ("4060 Shqopishte Alpine dhe Boreale") përgjatë shpateve më të rrëpirëta shkëmbore, dhe bashkësitë e *Nardus stricta* në zonat më të sheshta me një tokë të thellë dhe më të lagësht (Lloji 2). Në këtë matricë mbizotëruese ndodhen edhe habitate të tjera të rëndësishme të lokalizuara si habitatet *Mesophilous serpentine* përgjatë shpateve me *Festucopsis serpentine*, *Bornmuellera baldacii*,

Genista hassertiana, dhe habitetet ligatinore të rralla dhe të shpërndara ("7230-Moçaleet Alkaline") pranë moçaleve apo kënetave të vogla, me *Carex sp.pl.*, *Pinguicula balcanica* dhe *Nartheciumscardicum*. Bimësia gëlqerore e livadheve mbizotërohet nga bashkësitë *Festuca paniculata* ose *Bromus Erektus* ("6210-livadhet gjysmë-natyrore të thata dhe facie shkurre në nënshtresa gëlqerore (*Festuco-Brometalia*")), me praninë e bashkësive interesante të vogla me *Astragalus sirinicus* (4090-shqopishte me gjineshtër endemike oro-mesdhetare) dhe *Stipa spp.* (Tipi 3) që shpesh zhvillohen së bashku me shkurrishtet e "5130-formacioneve të *Juniperus communis* në shqopishte ose livadhe gëlqerore". Mbi majat dhe kreshtat gëlqerore zhvillohen bashkësi të rëndësishme kasmofitike (8210-shpate shkëmbore gëlqerore me bimësi kasmofitike (chasmophytic) të mbizotëruara nga lloje të rralla si *Saxifraga spp.*, *Ramonda serbica*, *Potentilla apennina* dhe *Moltkia petraea*. Habitete të tjera të rëndësishme janë bashkësitë bimore të shpërndara në rripira gurore të rralla të zonës ("8140-gurina mesdhetare lindore").

Lloje bimore me interes ruajtjeje (lloje të bimëve të përzgjedhura). Diversiteti i nënshtresave gjeologjike, me formacion shkëmbor shumë të lashtë që nga epoka paleozoike, vendndodhja në kufirin midis rajonit të ndryshëm biogeografik (malet e Ballkanit, rajoni i Mesdheut dhe kufiri jugor i Evropës kontinentale), pjerrësia e madhe në lartësi dhe vazhdimësia e relikteve të rralla të mjediseve strehuese të Ballkanit gjatë periudhave akullnajore kanë përcaktuar gjithashtu një florë të pasur dhe interesante. Kemi identifikuar 26 lloje bimore të përzgjedhura me interes të veçantë ruajtjeje (Harta 11, Shtojca 6 - lloje me shpërndarje të kufizuar ose të kërcënuara sipas kriterëve të Listës së Kuqe të IUCN-së, ose të përfshira në konventat e tjera ndërkombëtare). Nga këto, 23 janë përfshirë në listën e kuqe të të dhënave për Shqipërinë, duke përfshirë një lloj që është *Rrezikuar në Nivel Kritik*, pesë të tjera që janë të *Rrezikuara* dhe shtatë që konsiderohen të *Cenuara*. Dy lloje janë renditur në listën e kuqe të të dhënave për Evropën dhe pesë në listën e kuqe të të dhënave botërore. Tetë nga llojet e renditura janë endemike apo sub-endemike për Shqipërinë dhe shtatë lloje të tjera janë endemike për Ballkanin.

Fauna. PKSHJ-ja ofron një habitat të rëndësishëm për lloje të shumta të rëndësishme të kafshëve. Midis llojeve të shumta të gjitarëve, gjashtë renditen në Shtojcën II të Konventës së Bernës që kërkojnë mbrojtje të rreptë; katërmbëdhjetë lloje të tjera janë renditur në Librin e Kuq të faunës shqiptare (Shtojca 7). Llojet me interes të veçantë ruajtjeje janë: Ariu i Murrmë (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Vidra (*Lutra lutra*), Macja e Egër (*Felis silvestris*), Dhia e Egër (*Rupicapra rupicapra*), Miu i Drurit (*Apodemus sylvaticus*) dhe Hundëgjati i Vogël Dhëmbëbardhë (*Crocidura suaveolens*).

PKSHJ-ja favorizon një bashkësi të larmishme të shpendëve për shkak të shtrirjes së saj të madhe në lartësi dhe shumëllojshmërisë mbresëlënëse të tipave të habitateve. Studimi ornitologjik në terren i kryer për herë të parë në Park (mbi një javë gjatë muajit qershor të vitit 2013) u shtri në rreth 11% të sipërfaqes dhe në 16 tipe të habitateve. U regjistrua një numër i përgjithshëm prej 84 lloje të shpendëve, nga të cilat 67% janë renditur në Shtojcën II të Konventës së Bernës ("lloje rreptësisht të mbrojtura kafshësh") (Shtojca 7). Në veçanti, diversitete të larta të shpendëve janë gjetur në tokë të përzier bujqësore tradicionale, në livadhe të thata gëlqerore me shkurrishte *Juniperus communis* dhe në kullota alpine, të cilat gjithashtu strehonin numrin më të madh të llojeve të specialiteteve të tyre. Gjithashtu, mund të përfshihen në këtë kategori edhe pyjet parësore, por këto mund të studiohen vetëm në nivel të kufizuar për shkak të shpeshtësisë së ulët të tyre. Një pasuri më e vogël e llojeve u gjet në një nga habitetet më të dendura të Parkut, pyjet dytësore *Fagus sylvatica*, ku mbizotërojnë llojet e zakonshme si Zboraku, Bilbilthi Kokëzi dhe Fishkëllyesi i Vogël. Llojet më të rëndësishme të specializuara të regjistruara gjatë studimit njëjavor ishin Shqiponja e Maleve, Skifteri i Drurëve, Thëllëza e Shkëmbit, Dallëndyshja e Natës, Mëllenja e Shkëmbit, Qukapiku Kurrizbardhë dhe Qukapiku i Zi, Qafëdredhësi, Pupëza, Trishtili i Madh i Murrmë, Cerla Gushëgjelbër, Cerla Kokëzezë dhe Cerla e Zakonshme. Është thelbësore që të theksohet rëndësia e metodave tradicionale bujqësore ende të praktikuara gjerësisht, jo vetëm për diversitetin e tyre shumë të lartë të shpendëve (në kontekstin evropian), por edhe për një numër tepër të madh të llojeve të tilla si larasi kurrizkuq, lauresha, cerla e zakonshme, qyqja dhe cerla gushëgjelbër. Brenda dhe rreth fshatrave tufa të mëdha të trumcakëve të shtëpisë dhe trumcakëve të pemëve janë me interes të veçantë, pasi numri i të dy këtyre llojeve është duke rënë ndjeshëm në të gjithë Evropën. Ka pritshmëri të mëdha që studimet e mëtejshme të raportojnë shumë më tepër lloje të shpendëve, veçanërisht të atyre që janë më të kërcënuara dhe në numër më të paktë, të cilët janë edhe më të vështirë për tu konfirmuar.

Haixhiu (1998) regjistroi 10 lloje të zvarranikëve në Parkun e PKSHJ-së. Ne kemi mbledhur vëzhgimet oportune për 14 lloje (studimet në terren, 2013) dhe 15 lloje referuese të IUCN-së. Tetë lloje amfibësh janë

raportuar në faqen e internetit "Balcanica.info - amfibët dhe reptilët e Ballkanit" (<http://en.balcanica.info/35-0>), pesë lloje janë regjistruar në veprimtaritë tona në terren dhe dhjetë amfibë janë renditur në Listën e Kuqe të IUCN-së. Nevojitet të kryhet një studim i plotë dhe i standardizuar i Parkut për të përfunduar listat e kontrollit dhe shpërndarjen e llojeve. Disa prej llojeve të rralla të herpetofaunës janë: *Testudo hermanni*, *Algyroides nigropunctatus*, *Coronella austriaca*, *Coluber jugularis*, *Coluber najadum* dhe *Natrix tessellata*. Katër lloje amfibësh dhe 11 lloje zvarranikësh i përkasin listës së llojeve të Shtojcës II të Konventës së Bernës (Shtojca 7).

Regjistrohen katërmbëdhjetë lloje peshqish nga ujërat e lumenjve Shkumbin, Rrapun, Qarrishtë dhe Bushtricë. Këto përfshijnë pesë lloje që janë në Listën e Kuqe të IUCN-së: *Anguilla Anguilla* (e Rrezikuar në Nivel Kritik), *Oxynoemacheilus Pindus* (E Cënuar), *Barbus meridionalis* dhe *Rutilus rubilio* (të dy Pothuaj të Kërcënuar), (NT) dhe *Salmo trutta macrostigma* (DD). Në literaturën e botuar raportohet prezantimi i vetëm një lloji (*Pseudorasbora Parva*).

Infrastrukturat. Qytetet e vogla të Librazhdit (popullsia rreth 11,500 banorë) dhe Prrenjasit (popullsia rreth 8500 banorë) janë zonat kryesore urbane në afërsi të Parkut. Infrastruktura kryesore rrugore përshkon kufijtë jugorë, lindorë dhe veriorë të Parkut nga Prrenjasi në Librazhd për në Steblevë (Harta 13). Pjesa nga Librazhdi për në Prrenjas është një rrugë e mirë e shtruar, ndërsa traseja ekzistuese e pashtuar midis Librazhdit dhe Steblevës është aktualisht në proces punimi çakëlli me bitum. Kjo do të përmirësojë fuqimisht qasjen në sektorin verior të Parkut dhe në fund të kufirit me Maqedoninë. Në vende të tjera brenda Parkut ka disa rrugë të pashtuara dhe në një gjendje shumë të keqe. Ka një linjë hekurudhore që ndjek rrugën kryesore përgjatë kufijve jugorë dhe lindorë të parkut që lidh Pogradecin me anë të Prrenjasit dhe Librazhdin me Elbasanin dhe më gjerë.

Jeta socio-ekonomike. Rajoni i Elbasanit është i njohur për burimet e kromit dhe hekur-nikelit. Natyra e depozitave të kromit është e përshtatshme për operacionet në shkallë të vogël, duke përfshirë disa miniera që kanë funksionuar më parë brenda Parkut. Burimet e mineralit të nikelit kanë potencial për të tërhequr nivele më të mëdha të investimeve. Përveç minierave, ka edhe veprimtari të nxjerrjes së gurëve nga guroret, si dhe të nxjerrjes së zhavorrit nga lumi Shkumbin, veçanërisht në afërsi të Librazhdit.

Shoqëritë private kanë kërkuar tashmë leje nga komuna dhe ministritë për ndërtimin e nëntë hidrocentraleve, nga të cilat katër janë në ndërtim e sipër dhe dy janë tashmë në funksionim (Harta 14).

Popullsia e njerëzve në Park është relativisht e qëndrueshme në numër. Për shkak të opsioneve të kufizuara të mjeteve të jetesës, ka një nivel relativisht të lartë të emigrimit jashtë vendit, veçanërisht nga të rinjtë që kërkojnë punë në vende të tjera, kryesisht jashtë vendit. Shumica e familjeve janë përfshirë në aktivitete tradicionale bujqësore, të tilla si kulturat bujqësore dhe prodhimi blegtoral. Aktivitete të tjera të jetesës përfshijnë aktivitete me bazë pyjore (të drurit dhe druve të zjarri), mbledhjen e bimëve mjekësore, turizmin dhe prodhimin e peshkut.

Aktivitetet bujqësore dhe produktet bujqësore dhe blegtorale janë më të rëndësishme në ekonominë dhe jetën sociale të komuniteteve. Toka bujqësore është nën pronësi të familjeve. Rrethi ka pasur një industri duhani të njohur në nivel vendi, por kjo tani ka rënë. Numri i bagëtive dhe shpendëve është në rritje, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe mjeteve moderne të ndërthurura me ato tradicionale. Blegtoria dominohet nga dhitë dhe delet, ndërsa gjedhët luajnë rol të rëndësishëm në zonat më të ulëta. Është vlerësuar se kullotat e disponueshme në PKSHJ nuk do të mund të ruajnë në mënyrë të qëndrueshme numrin aktual të bagëtive në zonë.

Pyjet dhe burime të tjera biologjike japin kontribut të rëndësishëm për mirëqenien e komunitetit. PKSHJ është e pasur me bimë mjekësore, aromatike dhe ushqyese. Këto mbledhen kryesisht në gjendje të lirë në natyrë, por për disa lloje të veçanta prodhimi i tyre po shtohet nëpërmjet kultivimit. Në disa zona, aktiviteti kryesor ekonomik është punësimi në sektorin e pylltarisë dhe në mbledhjen dhe trajtimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Druri dhe lënda drusore nga pyjet natyrore janë burimi parësor i energjisë për gatim dhe ngrohje dhe material për ndërtimin rural. Zona pyjore përdoret gjithashtu për kultivimin e foragjerëve dhe kullotjen e bagëtive.

Aktualisht ka pak aktivitete turistike, megjithëse kjo po fillon të ndryshojë, për shembull, përmes ndërtimit të godinave të reja turistike në Steblevë. Ky proces pritet të rritet më tej pas përfundimit të një tuneli midis Tiranës dhe Elbasanit dhe rinovimit të rrugës kryesore hyrëse Librazhd-Steblevë.

Karakteristikat kulturore. Zona ka një histori të gjërë vendbanimesh të hershme që datojnë nga epoka e bronzit dhe hekurit. Gjatë pushtimit romak u ndërtua Rruga Egnatia për të lidhur Romën me

Kostandinopojën. Kjo rrugë ishte e një rëndësie të madhe për tregti dhe përshkon rrethin, duke qenë aktualisht rruga për autostradën moderne që lidh Tiranën me Shkupin nëpërmjet Liqenit të Ohrit. Pas rënies së Romës në vitin 476 pas Erës Sonë, rajoni ra nën pushtetin e Perandorisë Romake Lindore me qendër në Kostandinopojë deri në ardhjen e turqve nga viti 1415 e në vazhdim. Princi lokal Gjergj Arianit Komneni luftoi përkrah Skënderbeut dhe u dallua nga kronikanët osmanë për rezistencën e tij të ashpër ndaj përparimeve të turqve. Gjatë viteve të mëvonshme të Perandorisë Osmane, për shkak të ashpërsisë të terrenit dhe talentit për diplomaci dhe nepotizmit të ushtruar nga udhëheqësit lokalë, rajoni arriti një shkallë të konsiderueshme autonomie.

Burimet kulturore përfshijnë shpella, disa me piktura murale, vendet historike të tilla si Shkallët dhe Sofra e Skënderbeut, Muzeu Etnografik në Librazhd dhe aftësitë tradicionale në lidhje me gdhendjen e produkteve të drurit, mokrën dhe skulpturat e gurit, ndërtimin e shtëpive të gurit dhe prodhimin e batanijeve të leshit dhe veshjeve tradicionale (të karakterizuara në këtë zonë nga ngjyra të ndritshme).

1.3.2 Struktura e Ekosistemit, Shërbimet e Ekosistemit dhe Veprimtaritë Ekonomike

Komponentët kryesorë strukturorë dhe ndër-lidhjet e sistemeve ekologjike dhe socio-ekonomike të Parkut Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës paraqiten në Figurat 1.1 (ekosistemet kryesore), 1.2 (fauna), 1.3 (cikli i klimës, tokës dhe ujit) dhe 1.4 (sistemi ekonomik). Këto katër diagrama përfaqësojnë një model të përbërë të ekosistemit pasi janë të ndërlidhura nëpërmjet komponentëve të përbashkët (d.m.th. kanë të njëjtin emër) që përfaqësohen në dy ose më shumë diagrama. Në pjesën tjetër të këtij dokumenti, kur i bëhet një referencë e veçantë ndonjë prej komponentëve të ekosistemit të identifikuar në diagramat e mësipërme, teksti i lidhur me të është theksuar si i nënvizuar me ngjyrë blu (p.sh. [pyjet](#)).

Komponentët kryesorë të diagramës së përgjithshme të ekosistemit (Figura 1.1) janë:

- [klima](#),
- [toka](#) që përbëhet nga:
 - [kullotat natyrore](#) ([pyjet](#), [shkurrishtet](#), [shkurret e ulëta](#), [rreshqitjet e tokës dhe tokat jo pjellore](#))
 - [mjedise ujore](#) ([përrenj](#), [liqene](#))
 - [toka artificiale](#) ([rrugët](#), [toka bujqësore](#), [godinat](#), [hidronergjia](#))
- [fauna](#), e përbërë nga (Figura 1.2):
 - [fauna e egër](#)
 - [bagëtitë](#)
- [zjarri](#) së bashku me [shërbimet e ekosistemit](#) në formën e:
- [sistemimit të shërbimeve](#)
 - [rregullimit të klimës](#) ([rregullimi i cilësisë së ajrit](#), [rreziku gjeologjik](#))
- [furnizimit me produkte](#) ([përdorimi i ujit](#), [kulturat bujqësore](#), [produktet blegtorale](#), [produktet pyjore drusore](#), [produktet pyjore jo-drusore](#), [peshkimi](#))
- [shërbimet kulturore](#) ([atraksionet turistike](#)).

Komponentët kryesorë të ciklit të klimës dhe ujit (Figura 1.3) përfshijnë:

- [klimën](#) ([temperatura](#) dhe [reshjet](#));
- [burimet ujore](#) në formën e [ujërave nëntokësore](#) ([burimet](#)) dhe [ujërave sipërfaqësore](#) ([liqenet](#) dhe [përrenjtë](#)); dhe
- [përdorimin e ujit](#) në formën e [ujit të pijshëm](#), [sistemeve të ujitjes](#), [hidrocentraleve](#) dhe [akuakulturës](#).

Komponentët kryesorë të diagramës së sistemit ekonomik (Figura 1.4) janë:

- [bujqësia](#), [blegtoaria](#) dhe [agro-industria](#),
- [veprimtaritë ekonomike të lidhura me pyjet](#) ([produktet pyjore drusore](#), [produktet pyjore jo-drusore](#)),
- [turizmi](#),
- [peshkimi](#) dhe [akuakultura](#),
- [godinat dhe ndërtimet](#), dhe
- [minierat dhe guroret](#).

Përshkrimet e mëtejshme sasiore të zhvillimit, statusit dhe ndërveprimit të komponentëve të ekosistemit me njëri-tjetrin, të lidhura me sistemin natyror, infrastrukturën dhe zhvillimin, sistemin socio-ekonomik dhe karakteristikat kulturore, jepen në Shtojcën 8.

Figura 1.1 – Ekosistemi kryesor




Figura 1.2 - Fauna




Figura 1.3 – Cikli i klimës, tokës dhe ujit





Figura 1.4 – Sistemi socio-ekonomik i Parkut Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës



PJESA 2: VLERËSIMI I ZONËS SË MBROJTUR

Ky seksion identifikon karakteristikat kryesore që duhet të mbrohen për të ruajtur rëndësinë e zonës së mbrojtur (vlerat); faktorët që kërcënojnë këto vlera, pasuri dhe mundësi kryesore (kërcënimet), si dhe pikat e forta dhe kufizimet e kuadrit institucional aktual. Vlerat dhe kërcënimet janë përshkruar në lidhje me sistemet natyrore, socio-ekonomike dhe kulturore, siç përshkruhen në tabelat e raportuara në Shtojcën 9 (i referohen numrave të rreshtave specifike në këto tabela).

2.1 Vlerësimi i Vlerave

Sistemi Natyror

Vlerat, pasuritë dhe mundësitë kryesore të sistemit natyror ([mjediset ujore](#), [livadhet](#), [shkurrishtet-shkurret e ulëta dhe pyjet](#) - Rreshtat 2 deri 18) përfshijnë habitate të rëndësishme; diversitet të lartë bimësh dhe kafshësh dhe zhvillimin e një numri të madh të llojeve të bimëve dhe kafshëve endemike dhe të kërcënuara. Konsiderojmë habitate të rëndësishme ato që renditen në Direktivën e Habitaveve 92/43/KEE (me rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit në Evropë), ato të kufizuara në Shqipëri ose me lloje me shpërndarje të kufizuara, të rralla ose mbartëse të rëndësishme.

[Mjediset ujore](#). PKSJH-ja përfshin një zonë ujëmbledhëse të rëndësishme për Lumin Shkumbin, të karakterizuar nga prania e [ligeneve](#) të shumta alpine (natyrore dhe artificiale, Rreshti 18), [burimet](#) (Rreshti 33), [përrenjtë](#) dhe lumenjtë (Rreshti 16). Këto [mjedise ujore](#) ofrojnë një habitat të rëndësishëm për një shumëllojshmëri të llojeve ujore ([fauna e egër](#)), duke përfshirë lundërzat ([gjitaret](#), Rreshti 23) dhe troftën endemike ngjyrë kafe ([peshk i ujërave të ëmbla](#), Rreshti 30). Të shpërndara në të gjithë parkun, kryesisht në zonën më të lartë vullkanike qendrore, pranë moçaleve dhe kënetave të vogla ose në buzë të përrenjeve alpinë, mund të gjenden bashkësi të rëndësishme ligatinore (të renditura në Direktivën e Habitaveve si "7230-moçale alkaline"), në të cilat rriten lloje të rralla bimësh në Ballkan me shpërndarje të lokalizuar. Bashkësia e llojit të *Ranunculus tricophyllus* (3260-vija uji në nivele fushore-kodrinore me bimësi *Ranunculion fluitantis* dhe *Callitricho-Batrachion*) janë gjetur vetëm në liqenin e vogël Dragan.

Burimet e ujit janë gjithashtu të rëndësishme për jetën e popullsisë lokale: për qëllime kryesore (veçanërisht burimet, [uji i pijshëm](#), Rreshti 34), për ujitje ([sistemet e ujitjes](#), Rreshti 34), për [akuakulturë](#) (rreshti 47), për ndërtimin e [hidrocentraleve](#) (Rreshti 35), por edhe si pjesë e atraksionit të peizazhit dhe në këtë mënyrë për atraksionet e [turizmit](#) (Rreshti 1 dhe 46).

[Livadhet](#). Në brezin kryesor të lartësive (400-1000 m) kemi në përgjithësi një cenim të livadheve nga kullotja intensive, me vlera jo të rëndësishme të biodiversitetit përveç fushës së Studës, ku gjenden livadhe me një pasuri të madhe floristike.

Në brezin malor dhe nën-alpin (1000-1800 m) bashkësitë më të rëndësishme të livadheve janë ato që rriten mbi nënshtresat toksike serpentinore. Ato formojnë një mozaik kompleks me shkurre të mbizotërohen nga *Buxus sempervirens* dhe *Juniperus oxycedrus*, të cilat janë krijuar nga prerjet e drurëve, zjarret dhe kullotjet. Kjo nënshtresë selektive tërheq komunitetet me një florë tejet të dallueshme të Ballkanit të karakterizuar nga lloje të specializuara, me rritje të ngadaltë, dhe shpesh me shpërndarje të kufizuara. Habitata të tjera të rëndësishme janë livadhet e thatë gëlqerorë të tipit të stepave të *Festuco-Brometea* që zakonisht rriten në kontakt me shkurre të *Juniperus communis* apo pyjet me *Fagus sylvatica*: ato renditen në Direktivën e Habitaveve si "6210-Kullota të thata gjysmë-natyrore dhe shkurre facie në nënshtresat gëlqerore (*Festuco-Brometalia*)". Ndër këto livadhe, me nënshtresa guri apo shkëmbore, mbi një tokë shumë të hollë dhe të thatë, mund të gjenden bashkësi të shpërndara të *Astragalus sirinicus* (4090-shqopishte gjineshtre endemike oro-mesdhetare). Në tokë më të thella dhe më të pasur, në periferi të pyjeve me *Fagus sylvatica*, mund të gjenden bashkësi të tjera interesante që mbizotërohen nga lloji i rallë i *Geranium sylvaticum* dhe *Geum rivale* (6430-bashkësi të hidrophileve të gjata barishtore në periferi të fushës dhe malit në nivelet alpine).

Mbi vijën e pemëve (1800-2250 m) mund të gjenden disa bashkësi të rëndësishme livadhesh. Në pjesën vullkanike, në pjesën qendrore të Parkut, shpatet e pjerrëta dhe shkëmborë të majave më të larta mbizotërohen nga një mozaik me livadhe të *Sesleria coerulans* të Ballkanit Panonian dhe shqopishte me

shkurre të ulëta të *Erica carnea* ("4060-Shqipishte Alpine dhe Boreale"), të dyja të pasura me lloje të rëndësishme. Pllaja mbizotërohet nga kullotat me *Nardus stricta*, të cilat mund dhe duhet të përfshihen në Habitatin "6230- livadhe të pasura me lloje *Nardus*, me nënshtresa silici të zonave malore (dhe zonat nën-malore të Evropës Kontinentale)".

Këto livadhe gjithashtu ofrojnë një habitat të rëndësishëm për një shumëllojshmëri të kafshëve ([faune e egër](#)) që përfshijnë dhinë e egër ([Gjitarët](#), Rreshti 23) dhe Grabitqarët si Shqiponja e Maleve ([Shpendët](#), Rreshti 25). Nga një perspektivë socio-ekonomike, livadhet sigurojnë burime të rëndësishme të kullotave për [bagëtinë](#) (Rreshti 21) si dhe janë fusha të rëndësishme për mbledhjen e bimëve mjekësore ([produkte pyjore jo-drusore](#), Rreshti 49), si *Thymus sp.*, *Gentiana lutea*, *Sideritis syriaca*, *Hypericum perforatum*, *Satureja montana* dhe *Origanum vulgare*.

Shkurrishtet dhe Shkurret e Ulëta. Shkurrishtet me *Juniperus communis* në brezat kryesorë dhe malorë, në formacione gëlqerore, renditen në D.H. si "5130- formacione të *Juniperus communis* në livadhe shqipishtesh ose gëlqerore". Në sektorin më të lartë të parkut, në përgjithësi mbi vijën e pemëve, gjenden shkurre të ulëta që karakterizohen nga *Erica carnea* dhe *Genista hassertiana* ("4060-Shqipishte Alpine dhe Boreale") të cilat janë të pasura me lloje endemike ose sub-endemike.

Pyjet. Pothuajse të gjitha tipologjitë e pyjeve mund të klasifikohen si habitate të Direktivës së Habitaveve. Fragmentet e bimësisë bregore që mbizotërohen nga *Platanus orientalis* që rritet në zonën kryesore (400-1000m) klasifikohen si "92C0-Pyjet *Platanus orientalis* dhe *Liquidambar orientalis*". [Pyjet gjetherënëse termofile](#) (Rreshti 12) me *Quercus frainetto-Q. cerris*, mbi përbërje konglomerate dhe gur ranor, dhe pyjet me *Q. petraea* mbi shkëmb vullkanik, përshkruhen si "91M0 Pyll dushku Panonian-Ballkanik me qarr dhe bunge". Këto janë habitate të rëndësishme që shpesh janë degraduar nga mbishfrytëzimi që përcakton një hapje të mëtejshme ndaj erozionit të tokës dhe humbjes së llojeve pyjore.

Në krahinën malore dhe në brezin nën-alpin (1000-1800m) bimësia mbizotërohet nga pyjet *Fagus sylvatica* të renditura si "91K0-Pyjet Ilire *Fagus sylvatica* (*Aremonio-Fagion*)". Këtu, kryesisht në lartësi më të mëdha dhe në nënshtresat vullkanike, mund të gjenden edhe pyjet e rralla *Pinus peuce* të Ballkanit (95A0- Pyjet me pisha të larta oro-mesdhetare).

Pyjet ofrojnë një habitat të rëndësishëm për një numër të [gjitarëve](#) nga ato të mesëm në ato më të mëdhenj, që përfshijnë rrëqebullin e Ballkanit, ujkun dhe ariun e murrmë (Rreshti 16). Pyjet janë gjithashtu burime të rëndësishme të drurit ([lëndë drusore](#)), [dru zjarri](#) (Rreshti 50) dhe të një shumëllojshmërie të produkteve pyjore jo-drusore, që përfshijnë bimët me fruta pylli dhe dëllinjat (rreshti 49); [pyjet termofile gjetherënëse](#) (pyjet e dushkut) të cilat janë në veçanti të rëndësishme si burim ushqim dimëror për [bagëtinë](#) (Rreshti 21) dhe pyjet që luajnë rol të rëndësishëm në rregullimin e cilësisë së ujit (p.sh. përmes zvogëlimit të pranisë së metaleve të rënda në të) dhe të regjimit të rrjedhës së tyre; duke zvogëluar rrezikun e rrëshqitjeve të dheut përmes rritjes së depërtimit të ujit dhe stabilizimit të tokës ([rreziku gjeologjik](#), Rreshti 11); që zvogëlojnë shkallën e erozionit të tokës; dhe shërbejnë si një filtër karbonik, duke reduktuar kështu rrezikun e ndryshimit të klimës; dhe që shërbejnë si një atraksion kryesor për [turizmin](#) duke kontribuar në bukurinë piktoreske të peizazhit.

Diversiteti i Lartë i Llojeve

Biodiversiteti i PKSHJ-së është një rezultat kompleks dhe dinamik i disa faktorëve: e një shtrirjeje të madhe në lartësi (afërsisht nga 300 deri në 2200 m), si dhe e përdorimit të tokës që e kombinuar me shkallët e mëdha të diversitetit gjeologjik, topografik dhe klimatik, kanë konstatuar praninë e 25 habitateve, të cilat janë të afta të mbështesin jetesën e grupeve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. Mbledhja e të dhënave në terren në vitin 2013 u përqendrua tek zogjtë dhe prania e gjitarëve të mëdhenj dhe të mesëm. Nëpërmjet përdorimit të 20 kamerave të vendosura si kamera-kurth (camera traps), ne ishim në gjendje të mblidhnim të dhëna për praninë e 11 gjitarëve nga 20 gjitarë gjithsej të regjistruar më parë. Lloje të veçanta, si ato të Ariut të Murrmë, Ujkut dhe Maces së Egër u fotografuan nga një numër i paparashikueshëm i kamerave, duke shtruar pyetjen nëse edhe sasia e tyre është ndoshta po aq e rëndësishme sa edhe prania e tyre. Gjatë vrojtimit të zogjve, 84 lloje zogjsh u regjistruan brenda parkut, gjë që tregon që si sasia ashtu dhe diversiteti i tyre ndikohet pozitivisht nga menaxhimi i bujqësisë tradicionale dhe negativisht nga menaxhimi i pyjeve. Numri i madh i llojeve të shpendëve dhe gjitarëve dhe shumëllojshmëria e madhe e habitateve tregon se larmia e llojeve të tjera të kafshëve të egra, si larmia e

jovertebrorëve, ka gjithashtu gjasa të jetë e spikatur, dhe për këtë arsye, biodiversiteti i faunës së egër të parkut nuk është vetëm i një rëndësie kombëtare, por edhe ndërkombëtare.

Lloje të rëndësishme bimore. Habitatet e renditura më sipër ofrojnë një florë të pasur me disa lloje të rëndësishme bimore bazuar në kritere të ndryshme: lloje endemike apo lloje me shpërndarje të kufizuar, lloje të Kërcënuara (të renditura sipas Listës së Kuqe të IUCN-së për Shqipërinë, Evropën apo Botën), ose me lloje me vlerë ekonomike. Gjithsej, janë identifikuar një numër total prej 26 lloje me interes ruajtjeje (Shtojca 6). Bazuar në praninë e llojeve të bimëve të Rrezikuara dhe Endemike/ të Kufizuara, në pasurinë e përgjithshme të llojeve dhe praninë e habitateve të rëndësishme në nivel kombëtar apo rajonal, kjo PKSHTJ identifikohet si një nga 45 Zonat e Rëndësishme të Bimëve të vendit.

Në ligatinat e vogla dhe të shpërndara, duke përfshirë burimet, moçalishtet dhe përrrenjtë alpinë, mund të gjenden lloje të rëndësishme me përhapje të kufizuar në Ballkan, si *Pinguicula balcanica*, *Nartheciumscardicum* (Endemike e Ballkanit, A1b e Cënuar,) si dhe *Soldanella pindicola*.

Bashkësitë serpentine që rriten në brezin malor dhe alpin, mbi gurët e dala në sipërfaqe të këtij shkëmbi toksik dhe selektiv vullkanik, ofrojnë një florë të rrallë me lloje të llojeve të rëndësishme të Ballkanit dhe ato të Kërcënuara si *Alyssum bertolonii* (Endemike të Ballkanit, me shkallë të Ulët Rreziku), *Sedum serpentini* (Rrezik të Ulët), si dhe më rrallë, *Festucopsis serpentini* (Endemike, jo e Vlerësuar). Në të njëjtën lartësi, por në shkëmbinj gëlqerorë, mund të gjejmë kullota të thata të stepës të *Festuco-Brometea*, të cilat ofrojnë disa lloje bimësh që mblidhen si bimë mjekësore nga banorët vendas, si *Thymus spp.*, *Gentiana lutea*, *Sideritis syriaca*, *Hypericum perforatum*, *Satureja montana* dhe *Origanum vulgare*.

Në livadhet dhe shkurret e ulta mbi vijën e pemëve, mbi shkëmbinjtë vullkanikë, mund të gjenden lloje të tjera të rralla dhe të kërcënuara të bimëve me shpërndarje të kufizuar, si: *Alkanna scardica* (sub-endemike, me shkallë të ulët rreziku), *Anthyllis vulneraria subsp. balgarica* (sub-endemike), *Bornmuellera Baldacci* (e Kërcënuar A1b), *Genista hassertiana* (sub-endemike, Pothuaj e Rrezikuar), *Gentiana lutea* (e Rrezikuar A1b), *Lilium albanicum* (sub-endemike, E Rrezikuar në Nivel Kritik 1b) filizat e *Pinus peuce* (Endemike e Ballkanit, e Rrezikuar A1b) dhe *Viola magellensis*. Në majat dhe kreshtat e maleve gëlqerorë rriten bashkësitë kasmofitike (chasmophytic), të mbizotëruara nga lloje të rralla dhe të kërcënuara si *Moltkia petraea*, *Potentilla apennina* dhe *Ramonda serbica* (Endemike e Ballkanit, e Cënuar A1b).

Lloje të rëndësishme të kafshëve. Llojet e rëndësishme të kafshëve përfshijnë disa gjitarë dhe kërcënuar në nivel mesatar dhe të lartë, si Ariu i Murrmë (*Ursus arctos*), Rrëqebulli i rrezikuar i Ballkanit (*Lynx lynx martinoi*), Vidra pothuaj e Kërcënuar (*Lutra lutra*), si dhe Ujku (*Canis lupus*), Macja e Egër (*Felis silvestris*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*) dhe Dhia e Egër (*Rupicapra rupicapra*) (Rreshti 16). Niveli i lartë i regjistrimit të disa llojeve të shpendëve, disa prej të cilave janë të mbrojtur bazuar në programe të fokusuar në vende të tjera evropiane për shkak të uljes së numrit të popullatës së tyre, evidentoi një sasi shumë të madhe të habitatit të përshtatshëm, për shembull, *Lanius collurio*, *Luscinia megarhyncho* dhe *Serinus Serinus* (të gjitha të Konventës së Bernës, Kategoria II). Lloje të tjera të rëndësishme përfshijnë kafshët grabitqare, si Shqiponja e Maleve (*Aquila chrysaetos*) (Rreshti 17); Breshka *Testudo hermanni* (Rreshti 18) dhe Bolla me Katër Vija *Elaphe quatuorelineata* (të gjithë Pothuaj të Kërcënuar), si dhe disa lloje peshqish si *Anguilla Anguilla* (E Rrezikuar në Nivel Kritik), *Oxinoemacheilus Pindit* (E Rrezikuar) dhe *Barbus meridionalis* dhe *Rutilus rubilio* (të dyja Pothuaj të Kërcënuara) (Rreshti 20).

Sistemi socio-ekonomik

Vlerat socio-ekonomike të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (PKSHJ) lidhen me përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve që mund të ofrohen nga ekosistemi i saj. Këto përfshijnë sigurimin e [burimeve ujore](#) (Rreshti 43), praninë e një shumëllojshmërie të [atraksioneve turistike](#) të mundshme (Rreshtat 1 dhe 46) që lidhen si me vlerat natyrore edhe ato kulturore të Parkut, një [sistem bujqësor](#) tradicional (Rreshti 44) me mundësi të mira për produkte ekologjike specifike dhe të cilësisë së lartë; prodhimi i drurit dhe i një shumëllojshmërie të produkteve jo-drusore të pyjeve ([produkte pyjore drusore](#) dhe [produkte pyjore jo-drusore](#)), si dhe mundësi për prodhimin e peshkut me anë të [akuakulturës](#).

Sistemi Kulturor

Parku përfshin disa vende historike, si shkalla dhe tryeza e Skënderbeut, dhe veçori kulturore, si shpella natyrore (si për shembull shpellat "e Akullit", "të Krishtit" dhe "të Eremitit"), disa prej të cilave kanë piktura murale. Vlera të tjera kulturore përfshijnë fshatin e lashtë të Qutësit dhe ekzistencën e vazhdueshme të

zanateve tradicionale që lidhen me aspekte të tilla si gdhendja e produkteve të drurit, prodhimi i sendeve prej guri si guri i mullirit, ndërtimi i shtëpive të gurit, prodhimi i kostumeve tradicionale dhe performanca e valleve tradicionale. Muzeu Etnografik në Librazhd, edhe pse i dëmtuar ndjeshëm, paraqet një depozitim të rëndësishëm lokal të historisë dhe dijeve kulturore. Një panair kulturor zhvillohet çdo vit në Steblevë. Karakteristikat kulturore konsiderohen së bashku si pjesë e [atraksioneve turistike](#).

2.2 Vlerësimi i Kërcënimeve

Sistemi natyror

Kërcënimet kryesore të drejtpërdrejta ndaj sistemit natyror janë modifikimet dhe humbjet e habitatit, përdorimi i tepruar i burimeve dhe ndotja. Nuk identifikohen kërcënime specifike që vijnë nga prania apo invazioni i llojeve të huaja, si dhe ende nuk ka efekte që lidhen me ndryshimin e klimës.

Kërcënimet ndaj [burimeve ujore](#) (Rreshti 43) përfshijnë ato që vijnë nga devijimi i [përrenjve](#) dhe [burimeve](#) për zhvillimin [hidroenergjetik](#) (Rreshtat 16, 36 dhe 35), të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e organizmave ujorë ([amfibët](#), Rreshti 29, [peshqit e ujërave të ëmbla](#), Rreshti 30; dhe [jovvertebrorët](#) Rreshti 31), nga ndotja e lokalizuar si rezultat i shkarkimit të ujërave të ndotura drejtpërdrejt në [përrenj](#), si dhe nga aktivitetet minerare ([miniera dhe gurore](#) që shkaktojnë ndotjen me metale të rënda).

Çështje të tjera të mundshme si mbushja me lym e vijave të ujit dhe ndotja nga hedhja e mbetjeve të ngurta nuk identifikohen si një kërcënim në këtë fushë.

Po ashtu, mbishfrytëzimi dhe/ ose grumbullimi pa kriter i bimëve mjekësore identifikohet si një kërcënim për lloje të caktuara bimësh që kanë lidhje me bashkësitë e kullotave, veçanërisht bima endemike e Shqipërisë *Gentiana lutea* ([produkte pyjore jo-drusore](#), Rreshti 15).

Kërcënimi kryesor ndaj [pyjeve](#) (Rreshti 9) janë shpyllëzimet që lidhen me prerjet e tyre për foragjere, përdorimin si lëndë drusore, si dhe për dru zjarri ([veprimtari ekonomike që lidhen me pyjet](#)), veçanërisht në [pyjet gjetherënëse termofile](#) (Rreshtat 9 dhe 14). Mendohet se më parë zjarret kanë kontribuar në shpyllëzimet e pjesës së thyer nën-malore ([pyje gjetherënëse termofile](#)), por kjo aktualisht nuk konsiderohet problem serioz (Rreshti 2 dhe Rreshti 14).

Bimët dhe kafshët kërcënohen kryesisht nga format e papërshtatshme të përdorimit dhe/ose përdorimi i tepruar i burimeve, për shembull për shkak të devijimit të [burimeve ujore](#) për [hidrocentrale](#), mbipërdorimit dhe metodave shkatërruese të mbledhjes së bimëve mjekësore ([produkte pyjore jo-drusore](#)), shfrytëzimit të burimeve pyjore ([dru zjarri](#) dhe [lëndë drusore](#)) (Rreshtat 9, 12, 13 dhe 14) dhe [zjarreve](#), praktikave të paligjshme të peshkimit ([peshkimi](#), Rreshtat 16 dhe 48), gjuetisë pa leje të kafshëve të egra ([mish i kafshëve të egra](#), Rreshti 27); dhe nxjerrjes së torfës (për përdorim si lëndë djegëse) nga moçalishtet e vogla të shpërndara në Park. Nuk identifikohen kërcënime që lidhen me kullotjen nga blegtoaria apo aktivitete të tjera të zhvillimit, si ato që vijnë nga ndërtimi i [rrugëve](#), [godinave](#) (Rreshtat 6 dhe 8) (duke përfshirë edhe [infrastrukturën](#) për turizmin, Rreshti 46). Megjithatë, duhet theksuar se nuk disponohet informacion në lidhje me [rrugët](#) apo [godinat](#) apo për infrastrukturën turistike.

Sipas informacioneve paraprake lokale dhe të dhënave cilësore, minierat dhe guroret shkaktojnë ndotje të lokalizuar të rrjedhjeve të ujërave me metale të rënda (Rreshti 16).

Sistemi socio-ekonomik

Kufizimet më të gjera me të cilat përballen komunitetet lokale përfshijnë kushtet e vështira socio-ekonomike, mungesën e mundësive të punësimit lokal dhe rajonal, opsionet e kufizuara të mundësive të jetesës, zhvillimin e dobët të infrastrukturës dhe shërbimeve (mungesa e furnizimit me ujë të pastër, akses i kufizuar në energjinë elektrike, akses i pamjaftueshëm për përdorimin e rrugëve, akses i ulët në institucione arsimore dhe shëndetësore) dhe vështirësitë në shfrytëzimin e institucioneve financiare dhe të tregjeve. Në këtë mënyrë, njerëzit janë të detyruar të mbështeten në përdorimin e burimeve natyrore, duke ushtruar përdorim të dëmshëm dhe të paqëndrueshëm të burimeve.

Përveç kërcënimeve që lidhen me përdorimin e paqëndrueshëm të burimeve, si mbipërdorimi i kullotave nga bagëtia; mbishfrytëzimi i burimeve të foragjereve, druve të zjarrit dhe lëndës drusore; metodat e dëmshme dhe nivelet e paqëndrueshme të shfrytëzimit të bimëve, gjuetisë pa leje të kafshëve të egra, përdorimit të teknikave të dëmshme dhe niveleve të paqëndrueshme të kapjes të peshkut, kërcënimet

kryesore të jetesës lidhen me aksesin e kufizuar në burimet financiare dhe tregje, të cilat rezultojnë në një shkallë të kufizuar të aktiviteteve ekonomike. Në veçanti, turizmi paraqet një mundësi jetike ekonomike, por mund të dobësohet lehtë nga zhvillimi i pakontrolluar dhe agresiv, i cili mund të ulë shpejt atraktivitetin e zonës për vizitorët. Kërcënimet specifike të këtij sektori përfshijnë:

Ujin ([përdorimi i ujit](#)) - Zhvillimi i kufizuar i furnizimit me ujë të pastër ([uji i pijshëm](#), Rreshti 38); devijimi i ujit nga [përrenjtë](#) për projekte të [hidrocentraleve](#) (Rreshti 35); dhe ndotja e [përrenjve](#) nga shkarkimi i ujërave të ndotura të pa-trajtuara, si dhe [minierat dhe guroret](#) (Rreshti 16).

Bujqësinë ([bujqësia, blegtoaria dhe agro-industria](#)) - përveç kufizimeve të mëdha të burimeve natyrore për prodhimin e kulturave bujqësore (shpate të pjerrëta, toka të cekëta dhe jopjellore, tregues të lartë të erozionit), ka probleme të rëndësishme që lidhen me aksesin në kredi ([kapital financiar](#), Rreshti 44); me [sistemet bujqësore](#), si fragmentimi i tokës, shkallë të kufizuara të prodhimit dhe të mekanizimit të kufizuar (Rreshti 44), si dhe vështirësi të aksesit në tregjet ([marketingu dhe shpërndarja](#), Rreshti 45). Raportohen dëmtime të [kulturave bujqësore](#) nga arinjtë e egër dhe identifikohet si një kërcënim i mundshëm grabitja e [bagëtive](#) nga [gitarët e mëdhenj](#) si ujçërit, por nuk ekzistojnë të dhëna sasiore në lidhje me këto aspekte (Rreshti 24).

[Veprimtaritë ekonomike të lidhura me pyjet](#) - Ndikimet e mëparshme që kanë ardhur për shkak të [zjarreve](#) dhe shpyllëzimit, me qëllim mbipërdorimin e burimeve të lokalizuara (si bimët mjekësore ([produkte pyjore jo-drusore](#)), dhe burimet për përdorim foragjeresh, dru zjarri dhe përdorim drusor (Rreshtat 2, 9, 12 dhe 14).

[Turizmin](#) – Aktualisht, numri i vogël i vizitorëve paraqet kufizimin kryesor në sektorin e turizmit, edhe pse ky sektor perceptohet se ka mundësi të mira ([tregu](#), Rreshti 46). Në veçanti, përmirësimi i rrugëve Tiranë-Elbasan dhe Librazhd-Steblevë pritet të përmirësojë ndjeshëm aksesin në Park dhe të shoqërohet me një rritje të dukshme të vizitorëve në Park. Kërcënime të tjera të mundshme përfshijnë humbjen e vlerave natyrore ([atraksionet turistike](#), Rreshtat 1 dhe 46), përmes aktiviteteve të tilla si shpyllëzimi, gjuetia e tepërt dhe gjuetia pa leje e kafshëve të egra, përdorimi i metodave të dëmshme dhe i niveleve të paqëndrueshme të kapjes të peshkut, si dhe zhvillimi i pakontrolluar i infrastrukturës ([rrugët, godinat, minierat dhe guroret, hidrocentralet](#) dhe [infrastruktura](#) e turizmit).

[Peshkimin dhe akuakulturën](#) - kufizimet kryesore të [akuakulturës](#) janë kostot e larta të prodhimit, veçanërisht kostoja e lartë e ushqimit dhe aksesit i pamjaftueshëm në tregje ([tregti me shumicë/ pakicë](#)), së bashku me përdorimin e gjerë të metodave të peshkimit të paligjshëm nga [individë](#) të caktuar (Rreshtat 47 dhe 48).

Sistemi kulturor

Nuk vërehen kërcënime specifike për sa i përket vlerave kulturore, edhe pse restaurimi i muzeut etnografik në Librazhd pranohet si një mundësi e rëndësishme për ruajtjen e vlerave kulturore lokale.

2.3 Vlerësimi i Kuadrit Institucional

Deri në shkurt 2015, Parkut i mungonte një strukturë e dedikuar për administrimin dhe menaxhimin. Pas krijimit të Parkut në vitin 2008, përgjegjësia për menaxhimin e tij iu shtua aktiviteteve ekzistuese të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve Pyjore (DRSHP) të Librazhdit. Nuk ka aktualisht asnjë sistem menaxhimi në Park: deri tani Parku nuk ka pasur asnjë plan menaxhimi, personeli i Parkut nuk ka përshtime pune, nuk ka pasur procedura të qarta operacionale dhe as procedura të përcaktuara për monitorim dhe raportim. Personeli i Parkut (gjithsej 23 vetë që në përgjithësi kanë edhe detyra të tjera që nuk lidhen me menaxhimin e Parkut) kishte vetëm përvojë pylltarie, por ata nuk kishin kryer ndonjë trajnim shtesë për të përmirësuar njohuritë e tyre dhe për të zhvilluar aftësi të reja të rëndësishme mbi menaxhimin e parkut. I gjithë personeli përbëhej nga meshkuj. Buxheti operacional ishte tërësisht i pamjaftueshëm dhe nuk kishte asnjë infrastrukturë menaxhimi apo prani të përhershme të menaxhimit në kuadër të Parkut. Aktivitetet e menaxhimit fokusoheshin në problemet ditore, kryesisht në lidhje me inspektimin dhe patrullimin, dhe për shfrytëzimin e paligjshëm të pyllit (për lëndë drusore).

Çdo inspektor është përgjegjës për një sipërfaqe prej rreth 5,000-6,000 ha. Nëse dikush autorizohet për një veprimtari të paligjshme brenda Parkut, çështja i dërgohet për kompetencë Policisë. Në shumë raste

rezulton që edhe gjobat mbeten të papaguara, por edhe nëse paguhen, të ardhurat i dërgohen drejtpërdrejt qeverisë qendrore në vend që të mbahen në nivel vendor.

Parku kishte edhe probleme të ndarjeve të paqarta të përgjegjësive dhe integritit midis sektorëve të ministrive dhe autoriteteve vendore/ kombëtare, për shembull, midis bashkive dhe Agjencive Rajonale për Zonat e Mbrojtura (ARZM), si dhe të atyre që lidhen me planifikimin territorial dhe ndërtimin e infrastrukturës së re, si shtëpitë, minierat, hidroenergja dhe zhvillimet e turizmit.

Që nga muaji shkurt 2015, Agjencia Kombëtare e krijuar për Zonat e Mbrojtura, AKZM, ofron një mundësi të re institucionale të rëndësishme për përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura në vend dhe po përmirëson në një kohë të shpejtë mjedisin operacional për menaxhimin e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (PKSHJ). AKZM-ja është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, e cila zbatohet nëpërmjet agjencive të saj ekzekutuese, 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (ARZM).


Hartimi aktual i një plani menaxhimi ofron një mundësi të rëndësishme drejt përmirësimit të kapacitetit të menaxhimit të parkut. Plani i menaxhimit do të përmirësojë njohuritë për Parkun; do të japë udhëzime të qarta për përpjekjet e menaxhimit dhe mund të shërbejë si mjet komunikimi për Parkun dhe rritjen e të ardhurave.

PJESA 3: MENAXHIMI I ZONËS SË MBROJTUR

3.1 Pozicionimi i këtij Plani në hierarkinë e vendimmarrjes

Ekziston një hierarki nivelesh në vendimmarrje që përkon me faza të ndryshme të procesit të menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke përfshirë projektet, programet, planet dhe politikat (shih Figurën 3.1).

Figura 3.1. Plani në hierarkinë e vendimmarrjes (përshtatur nga: OECD 2006)



Në mënyrë logjike, politikat formësojnë planet, programet dhe projektet vijuese që i vënë ato në praktikë. Politikat qëndrojnë në majë të hierarkisë së vendimmarrjes. Teksa zbresim poshtë në hierarki nga politikat te projektet, natyra e vendimmarrjes ndryshon, sikurse edhe natyra e menaxhimit të detyrave që nevojiten. Analiza e niveleve të politikave priret të merret me një gamë më të gjerë skenarësh dhe opsionesh planifikimi. Veprimtaritë në nivel projekti zakonisht kanë specifikime të hartuara dhe të përshkruara mirë.

Në përputhje me këtë logjikë, në këtë plan: i) shtjellohen politikat e përshkruara në Ligjin Nr. 8906 për Zonat e Mbrojtura dhe VKM Nr. 682/2005 për shpalljen e PMLB-së për hartimin e Vizionit dhe Objektivave specifike për zonën e mbrojtur, ii) parashikohen një sërë Masash të bashkërenduara Menaxhimi për arritjen e këtyre objektivave dhe iii) identifikohet një numër Veprimesh Menaxhimi që vë në zbatim secilën nga masat e përmendura më sipër.

Sikurse u përshkrua në Hyrje, ky Plan duhet të përdoret si burim financimi për zbatimin, dhe për të siguruar që këto fonde të alokohen dhe shpenzohen e efikasitet dhe efektshmëri. Teksa këto fonde bëhen të disponueshme në mënyrë progresive, ekipi i menaxhimit të Zonës së Mbrojtur duhet të përcaktojë një Program vjetor apo shumëvjeçar për zbatimin e Veprimit të çdo plani. Këto programe duhet të përshkruajnë një program apo axhendë të organizuar angazhimesh (duke përfshirë angazhimet e aktorëve përveç atyre të administratës së Zonës së Mbrojtur), instrumentesh dhe/ose veprimtarish që shtellojnë dhe zbatojnë çdo veprim menaxhimi.

3.2 Vizioni dhe Objektivat

Vizioni: Menaxhimi i PKSHJ-së do të synojë ruajtjen e vlerave ekologjike dhe kulturore të tij, teksa zhvillohen potencialet e pashfrytëzuara të veprimtarive socio-ekonomike që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve të ofruara nga ekosistemi i Parkut.

Në përputhje me këtë vizion, janë përcaktuar dy objektiva kryesore për menaxhimin e Parkut sikurse përvijohen më poshtë:

Objektivi 1: Ruajtja e vlerave ekologjike dhe kulturore

- Kullotat (pyjet, livadhet dhe mjediset ujore)
- Fauna (kafshët e egra dhe bagëtia)
- Pikat e nxehta kulturore

Objektivi 2: Zhvillimi rural duke u mbështetur në përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve të ekosistemit

- Bujqësia dhe blegtoaria
- Turizmi
- Peshkimi dhe akuakultura
- Produktet pyjore

3.3 Zonat e Menaxhimit

Zonat ekzistuese të menaxhimit përbëhen nga (Harta 6):

- Zona Qendrore (14.046 ha) me mbrojtjen e Nivelit 1,
- Zona e Përdorimit të Qëndrueshëm (5.253 ha) me mbrojtjen e Nivelit 2,
- Zona e Rekreacionit (2.209 ha) me mbrojtjen e Nivelit 3, dhe
- Zona e Përdorimit Tradicional (12.420 ha) me mbrojtjen e Nivelit 4.


Për qëllimin e këtij plani menaxhimi, janë identifikuar veprimtaritë e propozuara të menaxhimit sipas komponentëve kryesorë të ekosistemit që përfshijnë habitatet natyrore dhe artificiale që përbëjnë komponentin e [tokës](#) të ekosistemit të Parkut (shih Figurën 1.1), dhe jo ato që kanë lidhje me zonat ekzistuese të menaxhimit. Kësisoj, çdo veprim menaxhimi lidhet drejtpërdrejt me një nga komponentët e mëposhtëm:

Toka

